



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS



**Tezë në kërkim të gradës shkencore
“DOKTOR”**

***Bashkëpunimi në planifikim midis autoriteteve
vendim-marrëse dhe aktorëve të tjerë***

Autor

MSc. Ark. Jonida MENIKU

Udhëheqës Shkencor

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

Prof. Dr. Adriana MIRI

TIRANË, 2016

MIRËNJOHJE

Per familjen time, per inkurajimin, durimin dhe sakrificat e bera, per te me mbeshtetur ne kete iniciative.

FALENDERIME

Se pari, shpeh falenderime te singerta per udhëheqësit shkencorë,
Prof. Dr. Andrea Maliqari dhe Prof. Dr. Adriana Miri , te cilet me eksperiencen dhe profesionalizmin e tyre kane kontribuar jo vetem ne realizimin e ketij punimi por ata jane edhe nje frymezim dhe model per mua.

Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, duke me mundesuar pjesemarrjen dhe duke me inkurajuar fort ne permbushjen e kesaj Doktorature.

Falenderoj kolege të Universitetit Politeknik të Tiranës, specialiste dhe punonjes te institucioneve te ndryshme, qe kontribuan ne konsultimet tekniko-profesionale, te perpunimit te teknikave te sugjeruara ne kete punim.

Tabela Permbledhese

1	Hyrje, Problemi, Objektivat.....	6
1.1	Hyrje.....	6
1.2	Problematikat dhe pyetjet e kerkimit.....	7
1.3	Objektivat	9
1.4	Struktura e tezës	10
2	Planifikimi ne Shqiperi, roli i autoriteteve vendimmarrëse.....	12
2.1	Zhvillimet urbano – arkitektonike ne kontekstin shqipëtar	12
2.2	Veshtrim historik.....	13
2.3	Informaliteti	21
2.4	Ndikimi i reformes administrative / territoriale ne hartimin e politikave te reja	22
3	Pjesemarrja e qytetareve si pjesë përberëse e demokracisë pjesëmarrëse.....	24
3.1	Historiku i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje	24
3.2	Format e pjesemarrjes	26
3.3	Konteksti evropian dhe botëror	29
3.4	Praktikat me te mira te pjesemarrjes dhe vendimmarrjes.....	32
3.5	Pjesemarrja e komunitetit ne projekte infrastrukturore	40
4	Korniza aktuale ligjore mbi Pjesëmarrjen	50
4.1	Bashkepunimi dhe mardheniet midis aktoreve në kontekstin e tranzicionit	53
4.2	Ligjet. Baza per te drejten e pjesëmarrjes ne vendimmarrje.	55
4.3	Çështjet Institucionale	59
4.4	Reflektime mbi ligjin.....	60
4.5	Rregullat dhe institucionet.....	61
5	Njohja dhe studimi i eksperiencës shqiptare ne procesin e bashkepunimit.....	62
5.1	Aspekte te vendimmarrjes	66
5.2	Autoritetet vendimmarrëse	68
5.3	Format e bashkepunimit (Rast studimor Gjirokastra)	71
6	Studimi i inteligjences artificiale	78
6.1	Teoria fuzzy, kuptimi dhe nocionet.....	82
6.2	Sfondi teorik. Parimet baze te modelit "Fuzzy Logic".....	86
6.3	Artificial Neural Networks (ANNs).....	88
7	Aplikimi i metodes « AHP » « FMCDM ».....	91
7.1	Vlersimi i kriterëve te shumta, ne procesin e vendim marrjes.....	91
7.2	Simulimi i Rastit Studimor	97
7.3	Rezultatet e simulimit te studimit pjesor urbanistik:.....	117
8	KONKLUSIONE.....	119
8.1	Rekomandime:	120
8.2	Sugjerime:.....	121
	Literatura	122
	Profil i autorit	125

Tabela e Figurave

Figura 1: Gjurma e planit te vitit 1929 mbi foton ajrore te Tiranes se sotme.....	14
Figura 2: Skema e pergjithshme e planit te vitit 1939-1943.....	16
Figura 3: Fotografi te Tiranës ne periudhen kur hartohej plani 1939-1943	16
Figura 4: Fotografi nga Tirana, 1962	18
Figura 5: Fotografi nga Tirana midis viteve 1957-1961	18
Figura 6: Fotografi nga Tirana prag viteve 90-te.....	19
Figura 7: Gjurma te informalitetit urban ne Shqiperi.....	21
Figura 8: Reformën administrative - territoriale 2014-2015	22
Figura 9: Angli, rast studimor	33
Figura 10: Hungari, rast studimor	35
Figura 11: Kroaci, rast studimor	38
Figura 12: Malit i Zi, rast studimor	39
Figura 13: Australi, rast studimor	40
Figura 14: Republika Ceke, Brno, rast studimor.....	43
Figura 15: Pozicionimi i njesive administrative n. 4 and 8, Tirana	45
Figura 16: Studim pjesor urban, plani i pergjithshem, rast studimor, Tirane	46
Figura 17: Pamje nga sheshi i ndertimi dhe rruget ne projektin infrastrukturor, Tirana.....	47
Figura 18: Pamje nga zbatimi i Projektit infrastrukturor, rast studimor.....	49
Figura 19: Fragmente nga projekti, rast studimor Gjirokastra.....	77
Figura 20: Saktesia kundrejte kuptimit ne praktike	83
Figura 21: Hapësira që zë inputi dhe outputi.....	83
Figura 22: Paraqitja e llogjikes FUZZY	84
Figura 23: Ilustrim i përgjithshëm i Logjikës Fuzzy	85
Figura 24: Plani i pergjithshem	91
Figura 25: Gen plan Akademia e Policise Sauk, (2008-2012).....	93
Figura 26: Foto te Godinave te rindertuara “Qendra e Formimit Policor”.....	96
Figura 27: Aksonometri e godinave	97

Pasqyra e Tabelave

Tabela 3.1: Tri nivelet e bashkëpunimit	28
Tabela 5.1: Autoritetet e planifikimit	68
Tabela 5.2: Autoritetet vendimmarrese Burimi, AKPT 2015.....	69
Tabela 5.3: Autoritetet vendimmarrese, Burimi, AKPT 2015.....	70
Tabela 5.4: Perdorimi i skemave te partneritetit publik privat	72
Tabela 5.5: Skema e Partneritetit Publik-Privat.....	73
Tabela 7.1: Aktoret pjesemarres ne projekt	97
Tabela 7.2: Hierarkia e struktures se projektimit te godinave	102
Tabela 7.3: Editori Fis per vleresimin e ambjentit, lloji Mandami	105
Tabela 7.4: Funksioni i antaresimit trekendor	106
Tabela 7.5: Funksioni i antaresimit trapezoidal	107
Tabela 7.6: Funksioni i antaresimit Singleton	107
Tabela 7.7: Funksioni i antaresimit Sigmoid	108
Tabela 7.8: Funksioni i antaresimit kambana	108
Tabela 7.9: Funksioni i antaresimit Guassiana	109
Tabela 7.10: Funksioni i antaresimit per variablin Vendodhja	109

Permbledhje

Shqipëria keto 25 vitet e fundit është endur midis “Vakumit dhe Energjise”. Vakumit, te zbrazëtise institucionale dhe energjise se pashtershme të njerëzve, shoqërisë, duke lëvruar përmes të ashtuquajturës “inteligjence komune”. Shqipëria ka një histori të ndërlikuar e të trazuar të planifikimit që daton që prej vitit 1950 e më tej. Përgjate viteve 1990-2000, Shqipëria ka përjetuar një transformim ekonomik, shoqëror, politik dhe urban, tepër kaotik, shoqëruar kjo me luhajtje në sjelljet e aktorëve kryesorë, duke filluar nga hartuesit e politikave e deri tek zhvilluesit e saj, ndaj dhe modeli i përfutur ka qenë jo i qendrueshëm. Për të kuptuar planifikimin dhe zhvillimet urbane në një vend, është e nevojshme të kuptohet konteksti historik, sidomos historia e neglizhencave të shoqërisë dhe reagimi kundrejt tyre, përmes sfidave me të cilat po përballen vendbanimet njerëzore.

Pas vitit 2000, vihet re futja e Shqipërisë në një fazë konsolidimi, zhvillimi dhe integrimi. Në shoqërinë shqipëtare filluan të evidentoheshin paradokset e se shkuarës, si dhe kontradita brenda vetë individëve, si pjesë e një shoqërie. Tashmë Planifikimi po shihet jo vetëm si një çështje thjesht teknike, por si një përpjekje për të përmisuar skeletin e shoqërisë, ndërsa kjo evoluon dhe ndryshon çdo ditë.

Promovimi i inteligjences artificiale në fushën e urbanistikës dhe arkitektures nëpërmjet përdorimit të teknikave të Llogjikës Fuzzy, është një fushë aktive e hulumtimit, një stil, një trend bashkëkohor, i cili ka lindur si domosdoshmëri e përballjes me sfidat e mëdha të planifikimit urban. Në këtë punim lexohet qartë se aplikimi i inteligjences artificiale, vecanërisht formati i Llogjikës Fuzzy, ka potencialin për tu përdorur si instrument i rëndësishëm, në promovimin e rigjenerimit urban në Shqipëri.

Ky disertacion paraqet qasje të reja në përzgjedhjen e alternativave me të mira projektuese të një studimi pjesor urbanistik, por edhe më tej. Vlerësimi i kriterëve të shumta në projektim, analizat krahasuese, udhëzimet, modelet e fokusuara kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian kanë qenë burime të vlefshme për të vendosur se cilat praktika më të mira duhet të merreshin në konsideratë. Kjo metode/ strategji është e rëndësishme pasi me anë të kësaj teknike mund të përftohen vendimmarrje urbane të cilat nga variacione perceptuale transformohen në koncepte të matshme dhe konkrete, për të identifikuar një strukturë hapësinore, urbane.

Qëllimi është për të inkurajuar dhe sfiduar autoritetet vendim marrëse, për të inicuar veprimet përkatëse, në përpjekje për të gjetur shtratin e zhvillimit dhe lulëzimit në fushën urbano - arkitektonike.

Fjalë kyçe: planifikim urban, pjesëmarrje, vendim marrje, inteligjenca artificiale, llogjika fuzzy;

Summary

Albania is lacking relatively behind concerning the adoption of collaboration between stakeholders for a sustainable urban development projects. This research states that artificiale intelligence has the potential of becoming a direct response at giving stakeholders involves in projects, a voice in shaping their future environment for promoting urban regeneration in combination with respecting the principle of sustainability. The sustainable urban development projects realized these two decades in Albania by the government/municipality have faced problems not only with participation and collaboration between actors, but also with decision making process. There was no clear policy and guidelines developed which can guide the public sector and other partners in the process of forming effective partnerships. This is an indicator which has made the community participation and contribution to be limited. At the core of democratic development in Albania, is the need for people to believe that politician they elected to represent them, are addressing their concerns and best interests in improving the welfare and “quality of life” for local Community. The result is to create an area which improves profits and a good style of life; re-conceptualization of investment as an investment in urban infrastructure, an investment that even with a relatively low cost can have a large impact.

This document emphasizes the need for a real metamorphose to all barriers between builders and users which must be abolished, so that building and using become two different parts, of the same planning process.

The aim of this research is to identify how cooperation schemes, through a deep analyse can successfully assist in the implementation of national urban development policies, focusing mainly on the guidelines set by the European Union.

The following subtopic will be explained:

1. Sharing a common vision on the needs and expectations based on the analysis of different and original cases.
2. Artificial intelligence (Fuzzy Ilogic), versus sustainable development, new initiatives, drawing conclusions and identifying key success factors, identifying trails for progress and drawing recommendations.

The objective is to encourage public policy makers and local authorities in particular to undertake relevant actions in order to promote collaboration / partnership in the field of urban development.

This research concludes by an application of a model, based on artificiale intelligence

Keywords: partnerships, community, decision making, artificial intelligence, fuzzy logic;

KAPITULLI 1

1 Hyrje, Problemi, Objektivat

1.1 Hyrje

Pas përfundimit të epokës ku atributet fizike të planifikimit ishin një shqetësim i madh për të gjithë profesionistët (urbanistë, arkitektë) procesi i planifikimit u riorientua drejt ndërtimit të mjedisit fizik. Hartimi i aspekteve intelektuale të planifikimit dhe adresimi i të drejtave të individit dhe grupeve të interesit përbejnë sfidat reale dhe në ditët e sotme. Në fund të shekullit të 20-te, zhvillimet demokratike, politikat publike dhe pjesëmarrja e publikut në vendim marrje ka përcjelle debate të forta. Këto procese supozohet t'i japin të drejta aktoreve pjesëmarrës, dhe rrjedhimisht detyra e profesionistëve, e projektuesve urbanistë apo arkitektë, lind të jete përballja me këto fenomene për të justifikuar proceset vendim marrëse.

"Planifikuesit nuk mund të veprojnë në një vakum të lirë". Egzistojnë rregulla, norma dhe procese".

Profesionistët shpesh here janë kundër pjesëmarrjes së komunitetit/grupeve pjesëmarrëse, sepse supozohet të zbulohet sekreti profesional, të zhvishet paaftësia, dhe të shumëfishohen përgjegjësitë dhe konvertimi i tyre nga private në sociale. Akademikë janë kundër, për shkak se, "të planifikosh me pjesëmarrje nënkupton kundërshtimin e skemave", aty ku mësimi dhe hulumtimi janë të bazuara. Por nga ana tjetër Di Carlo pohon se "Arsyeja themelore për përdorimin e logjikës së planifikimit me pjesëmarrje të komunitetit, rrit vlerat dhe cilësinë e të jetuarit".

Te shumta janë situatat ku kërkohen të merren vendime në fushën e planifikimit, aty ku shpesh here lind domosdoshmeria për nisma nga autoritetet. "Situatat vendim marrëse janë zgjedhje veprimesh, për të cilat profesionistët kanë kapacitetin, autoritetin dhe aftësitë e duhura për të ndermarre. Te shumta janë edhe veprimet duke gjykuar zgjidhjet, alternativat dhe analizat cilësore, në përbushje të hapave drejt vendim marrjes, në proceset urbane, si dhe post-veprim vlerësimet e tyre. Marrja e vendimeve është një proces kompleks. Kjo jo vetëm në planifikim, por edhe në fusha të tjera shkencore dhe teknike, është subjekti i debateve të gjata dhe të diskutueshme. Në thelb është një nga fushat më të prekshme dhe interesante të njerëzimit.

Ky sukses shkakton edhe ndjekjen e studimeve në "Zhvillimin e inteligjencës artificiale (AI)" një fushë e frymëzuar nga njeriu, rreth aftësisë së trurit dhe logjikës së mendjes. Aplikimi i kësaj logjike, e ashtuquajtura logjika Fuzzy, është zgjerua gjatë 50 viteve të fundit. Kjo është logjika e cila përballë të kompleksitetit dhe pasigurisë së vendim marrjeve. Sisteme të tilla përfshijnë fushën e ekonomisë, psikologjisë, gjuhësisë, mjekësisë, filozofisë, e shumë të tjera ku konceptet baze janë Fuzzy. Në vitet 1970, edhe me pas, Llogjika Fuzzy u prezantua, u formulua, dhe madje edhe u shfrytëzua për të imituar modelet e mendjeve njerëzore. Mendimtarë në fushën urbane sapo kishte filluar të kuptonin se: "Modeli i mendjes njerëzore, si një sistem mësimi tani është i plotë". Me variacione, ai ka qenë përdorur për të përfaqësuar edhe vendim marrje politike.

Në këtë disertacion, këto probleme shihen si pjesë e realitetit të planifikimit, në përgjithësi, dhe të vendim marrjes, në veçanti. Prandaj, duke përdorur një instrument i cili është në gjendje të merret me këto lloje paqartësish, (përdorimi i Llogjikës Fuzzy), nënkupton edhe vlerat e këtij studimi.

1.2 Problematikat dhe pyetjet e kerkimit.

Në dhjetëvjeçarët e fundit në vendet e Evropës perëndimore u provua se « pjesëmarrja qytetare në planifikimin urban » është themelore për jetësimin e tij të suksesshëm. Komunikimi konstant mes qeverisë vendore dhe qytetarëve për procesin e zhvillimit është mjaft i rëndësishëm. Vendimet që merren nga autoritetet vendore duhen shpjeguar. Përvoja ka treguar se procesi pëson vonesa në kohë, kur komunikimi nuk është organizuar mirë. Interesat e njerëzve në planifikimin urban po rriten se tepërmi dita dites, pasi ata janë të vetëdijshëm se planifikimi urban lidhet ngushtesisht me rezultatet ekonomike dhe të ardhmen ekonomike të tyre.

Në raportin e Progresit të vitit 2014, të hartuar nga Komisioni European për Shqipërinë, nënvizohet fakti *se qeverisja vendore/lokale në Shqipëri karakterizohet nga mungesa e transparencës në vendim marrje dhe nga mungesa e konsultimit me organizatat e shoqërisë civile apo grupeve të tjera të interesit*. Ky publikim vjen si rezultat i monitorimit disa mujor (shtator 2013 - shkurt 2014) të transparencës së veprimtarisë dhe pjesëmarrjes së publikut në Këshillat Bashkiak të Bashkive: Durrës, Elbasan, Kukës, Lezhë dhe Pogradec. Nga ana tjetër ky raport konkludon edhe në veshtiresite që hasen në lidhje me "njohjen me aktet " (Akti është materializimi ose produkti i procesit vendim marrës). *Edhe pse publikut mund t'i jetë garantuar pjesëmarrja në procesin vendim marrës, në rast se atij nuk do t'i garantohen mundësitë efektive për njohjen me aktin ku u finalizua ky proces, pjesëmarrja do të humbiste vlerën e saj*.

Besimi në organet publike vendore ndikohet nga dy faktorë: nga cilësia e shërbimit që marrin individët dhe familjet e tyre, dhe nga fakti se sa transparente dhe të ndershme janë autoritetet në lidhje me performancën e tyre, duke përfshirë, gadishmërinë e tyre për të pranuar dhe për të mësuar rreth gabimeve të tyre.

Gabimet njerëzore, problemet menaxheriale, kontradiktat në rolin e planifikuesit egzistojnë dhe janë të pashmangshme. Ndjenjat personale dhe profesionale, objektivat e punëdhënësit, dhe kodi i etikës së institutit përfaqesues janë disa nga kontradiktat aktuale të planifikimit.

Transparenca nuk ndihmon vetëm në informimin e publikut në lidhje me zhvillimin e ideve dhe propozimeve, por edhe për të bindur qytetarët se agjensitë publike janë të interesuara në dëgjimin e pikëpamjeve të tyre dhe përgjigjen e prioriteteve të qytetarëve. Kjo nga ana tjetër rrit legjitimitetin e procesit të vendim marrjes dhe forcon "demokracinë e drejtpërdrejtë ". Transparenca gjithashtu ndikon në angazhimin qytetar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Qeveritë lokale/vendore duhet të ndajnë vlerësimet dhe planet e tyre me qytetarët si edhe të kërkojnë pikëpamjet e tyre mbi baza të rregulta të cilat mund të jenë shumë efektive në zbatimin e programeve të zhvillimit të komunitetit .

Nëse planifikimi shihet në kontekstin e një shoqërie demokratike të mirëfillte, dhe në një drejtësi të tillë të lirë të shoqërisë është përcaktuar brenda mendimi utilitar, më tepër se

radikal, duke përcaktuar dhe kontrollin e tregut të lirë, atëherë çështja e vendim marrjes do të justifikohet vetëm me kontributet e njerëzve në vendimmarrje proces.

Campell dhe Feinstein ofrojnë këto panorame të teorisë së planifikimit : Gjate kalimit të brezave, perparësitë me të rëndësishme në planifikim janë:

- fuqia e komunikimit
- ndërmjetësimi midis paleve
- lidhja komplekse midis diversitetit, barazisë dhe komunikimit

Teoritë në lidhje me vendim marrjen, nuk janë të bazuara në rregulla strikte. Ato shpesh ndryshojnë, ndaj dhe turbulencat në proceset vendim marrese janë të pritshme dhe të pranishme.

C’lloj cilesish dhe standartesh, specifikash duhet të ketë procesi i vendim marrjes, që të jetë i justifikuar?

Si mund të arrihet kjo? A mundet që procesi i vendim marrjes të përfitojë nga llogjika Fuzzy, për ta përmirësuar këtë proces? A mundet që llogjika Fuzzy me të gjitha aplikacionet e saj, të ofrohet si një mënyrë alternative e të menduarit të llogjikës së planifikimit ?

A mund të hartohet një model vendim marrës për sistemet urbane në Shqipëri, duke përdorur llogjikën e Inteligjencës artificiale (Fuzzy rules) ?

A mund të adaptohet një model vendim marres me qëllim ngritjen kapaciteteve vendore për një zhvillim urban të qëndrueshëm në Shqipëri ?

A do ta rrisi ky model performancën dhe cilësinë e projekteve?

Sfidat e hasura.

Vonesa në hartimin e “Planit të përgjithshëm kombëtar” ka demtuar peisazhin natyror si dhe ka shkaktuar dëme ekonomike kombëtare.

Në realitet qendrat urbane janë zhvilluara spontanisht, përmes Teorisë mikroekonomike.

Ligjet urbane nuk kanë qenë në gjendje të sigurojnë bazën për bashkëpunim institucional në mes të gjithë aktoreve.

- Aktoret e përfshirë në planifikim vuajnë mungesën e aftësive teknike
- Aktoret të pa organizuar dhe me pak burime
- Planit nuk janë subjekt i konsultimeve dhe degjimeve publike (publik i përfshirë) – vendim marrje e njehshme
- Mentaliteti i ndrydhur për sa i përket transparencës
- Miti i “interesave”. midis aktoreve – vendim marrje të njehshme
- Mashtrimi nga “urgjenca” – vendim marrje të njehshme



Pranimi i perdorimit te AI (inteligjences artificiale) dhe aplikimit te saj (llogjika Fuzzy) si nje llogjike alternative ne sferen e vendim marrjeve ne fushen urbano-arkitektonike ?
PO/JO

1.3 Objektivat

**Objektivi kryesor i ketij kerkimi eshte vleresimi i bashkepunimit dhe procesit te vendim marrjes, midis aktoreve te ndryshem ne sistemet urbane ne Shqiperi.
Evidentimi i mundesive dhe alternativave per nderhyrje rigjeneruese ne to.**

Pyetjet e kerkimit:

- A mund te adaptohet nje model vendim marres, me qellim ngritjen e kapaciteteve lokale ne fushen e planifikimit dhe administrimit te territorit?
- Cilet jane kushtet dhe faktoret aktual qe ndikojne ne procesin vendim marrjes?
- Si mund te sherbeje ky model,ne vendin tone, per institucionet vendim marrese?
- A do ta rrisi ky Model, performancen dhe cilesine e projekteve?

Aktualiteti i institucioneve shqiptare.

Institucionet publike akoma te brishta;
Nepunes civile qe nuk njohin mire legjislacionin/detyrimet;
Mentalitet ende i ndrydhur sa i perket transparences;
Publik i pa informuar;
Aktore interesi te pa organizuar dhe me pak burime;

Qellimi: Eshte krijimi i qasjeve dhe modeleve qe ndihmojne dhe promovojne procesin e bashkepunimit /dialogut dhe vendim marrjes, per rritjen e performances dhe cilesise, per nje zhvillim urban te qendrueshem ne Shqiperi

Metodologjia:

Hartimi i nje modeli Vendim Marres per sistemet urbane ne Shqiperi, duke perdorur llogjiken e INTELIGJENCES ARTIFICIALE. (Fuzzy rules)

Njohja dhe studimi i sfondit teorik dhe eksperiencës ndërkombetare

Njohje dhe studime te eksperiencës shqiptare

1.4 Struktura e tezës

Puna kërkimore në këtë disertacion mbështetet në një proces disavjeçar hulumtimi dhe studimi mbi bashkepunimin midis autoriteteve vendim marrese dhe aktoreve te tjere.

Metodologjia e kërkimit ka ndërthurur disa linja që konsistojnë në:

- njohje dhe studim i sfondit teorik dhe eksperiencës ndërkombëtare
- njohje dhe studim i eksperiencës shqiptare
- njohje dhe studim i kuadrit ligjor
- studim i materialeve te publikuara në vitet e fundit
- njohje e drejtpërdrejtë e problemit nëpërmjet rilevimit dhe studimit në vend të problematikave
- zhvillim i intervistave
- vlerësim analitik i rasteve studimore
- simulim i bashkepunimit midis aktorëve ne procese urbane nëpërmjet programeve të avancuara kompjuterike

Disertacioni është paraqitur dhe strukturuar në tetë kapituj, përmbajtja e të cilëve paraqitet në vijim:

- Hyrje, problemi, objektivat. Në këtë kapitull bëhet një parantezë e kërkimit ku përcaktohen konteksti, përmbajtja, qëllimet dhe mjetet që janë përdorur gjatë hulumtimit. Gjithashtu, këtu bëhet edhe një përshkrim i përmblendhur i metodologjisë të kërkimit si dhe strukturës së disertacionit. (Kapitulli 1)
- Planifikimi ne Shqiperi. Roli i autoriteteve vendim marrëse, ndër vite, aktorët, institucionet dhe raporti midis tyre. Në kete kapitull ka një përmblendhje të historikut të zhvillimit të kësaj tipologjie si dhe një analizë të gjendjes së sotme fizike të procesit. Materialet e paraqitura janë pjesë e një kërkimi që mbështetet në të dhena arkivore. (Kapitulli 2)
- Aspekte të politikave pjesemarrëse ne kontekste te ndryshme.
Procesi i pjesëmarrjes. Intervista, materiale që synonin mbledhjen e të dhënave mbi aktoret, aktivitetin ditor, ne kontekstin funksional dhe ekonomik. Gjetjet dhe rezultatet janë paraqitur në këtë kapitull dhe shërbejnë si bazë për krijimin e modeleve të vlerësimit të performancës te projekteve urbano-arkitektonike. Rast studimor “Pjese marrja e komunitetit ne projekte infrastrukture, Tirane. (Kapitulli 3)

- Analize e ligjeve urbane ne raport me rolin e aktoreve te ndyshem, te drejten e pjesëmarrjes ne projekte zhvillimore dhe vendim marrjet ne to. Forcimi i kapaciteteve administrative, ne veprimtarite e prokurimeve publike. (Kapitulli 4)
- Studimi i eksperiencave shqiptare ne procesin e bashkepunimit. Njohja me autoritetet vendim marrese. Rast studimor Gjirokastra (Kapitulli 5)
- Studimi i inteligjences artificiale. Rregullatori Fuzzy, kuptimi dhe nocionet, rendesia e aplikimit te tij. (Kapitulli 6)
- Ngritja dhe simulimi i nje modeli. Krahاسimi, avantazhet dhe disavantazhet e perdorimit te llogjikes artificiale (Kapitulli 7)
- Konkluzione, Rekomandime, Sugjerime (Kapitulli 8)
- Literatura
- Profil i autorit

KAPITULLI 2

2 Planifikimi ne Shqiperi, roli i autoriteteve vendimmarrëse

2.1 Zhvillimet urbano – arkitektonike ne kontekstin shqipëtar

Përpara vitit 1990, ne Shqipëri, arkitektura dhe urbanistika ishte një disiplinë përmes së cilës pushtetet diktatoriale (fashiste dhe komuniste) vendosnin në territor **objektet e vendim marrjeve të tyre të centralizuara**. Ndryshimet e sistemeve politike dhe ekonomike i përballen institucionet jo vetëm me nevojën për reforma sektoriale, por edhe për ndryshim të mendësisë në përdorimin dhe shfrytëzimin e territorit .

Këto ndryshime kanë ndodhur gradualisht, me procese të hapura ose jo, në antagonizëm apo dakordësi me reforma të tjera, dhe i vecojme ne disa etapa:

Etapa e parë perfshin periudhen 1920-1931, kur synohet transformimi i vendbanimeve (Tirana nga pothuajse fshat shnderrohet ne kryeqytet);

Etapa e dytë perfshin periudhen nga 1939-1943, kur qytetet fillojne te shnderrohen (Tirana rithemelohe duke kaluar nga nje qytet organik ne nje qytet te organizuar);

Etapa e tretë perfshin periudhen nga 1957- 1958, (Tirana nga shkaterrimi i qendres historike deri tek krijimi i parkut te liqenit)

Etapa e katërt 1985-1989, (Tirana parandien shperthimin e madh, propozimi per zgjatimin e bulevardit, krijimin e pese unazave dhe tre parqeve periferike)

Etapa e peste pas viteve 1990 (Shperthimi i informalitetit, levizja drejt qendres)

Etapa e gjashte pas viteve 1997 (Rritje e informalitetit qe kulmoi ne vitin 1997, si pasoje e krizes ekonomike)

Etapa e shtate pas reformes territoriale 2014-2015, vihet re shumefishimi i popullsisë ne qytetet kryesore (Tirana eshte 4-fishuar ne raport me 25 vitet e meparshme)

Ne kete kapitull jane trajtuar vetem vizionet kryesore, në harkun kohor nga 1920- 2015. Keto jane pare edhe ne raport me sfondin historik te kohes. Keto evidentime dhe reflektime perbejne njëkohesisht konkluzione te rendesishme per praktiken e sotme te rolit te autoriteteve vendim marrëse dhe institucioneve ne Shqipëri.

Ajo cfare mungon ne kete rrugetim nder vite jane veprimet dhe vazhdimesia e veprimeve institucionale si pjese e vizioneve afatgjata. Shume energji mendore, intelektuale dhe monetare eshte shpenzuar per te krijuar kete pasuri, qe ne rastin me te mire nuk kane arritur as ta shohin e ca me teper ta kujtojnë dhe ne rastin me te keq nuk kane dashur ta kuptojne.

2.2 Veshtrim historik

Etapa e parë perfshin periudhen 1920-1931, kur synohet transformimi i vendbanimeve (Tirana nga pothuajse fshat shnderrohet ne kryeqytet);

Institucione te kohes – Autoritetet vendimmarrëse

Me poshte jane listuar disa nga institucionet me te rendesishme te cilat perfshiheshin ne procesin e hartimit dhe miratimit te planeve rregulluese dhe studimeve urbanistike te gjithe vendit:

Ne nivel kombetar: Monarki Kushtetuese, Mbreti i Monarkise Kushtetuese, Oborri Mbreteror, Keshilli i Ministrave, Ministria e Puneve Botore, Komisioni Teknik i Ministrise se Puneve Botore, Ministria e Puneve te Brendeshme, Departamenti i Mbrojtjes.

Ne nivel vendor: Bashkia, Zyra Teknike e Bashkise, Komisione per aprovime ne linje teknike.

Ne raportet e komunikimit ndihet se midis bashkise dhe ministrise ka patur nje lloj tensioni qe vinte si pasoje e mosperputhjes ne lidhje me disa koncepte te menyres se zhvillimit te qytetit te Tiranës. Keshtu nese propozimet e ministrise duket se ishin me drastike, ato te bashkise jane me realiste.

Kjo shfaqej ne kembenguljen e bashkise (plan i pergatitur nga bashkia) per hartimin e ketij plani si rezultat i shkrirjes se planeve te pergatitura nga tre autoret (Eshref Frasherit- plani i meparshem i pergatitur me 1928- plani i pare qe perfshinte te gjithe territorin e Tiranës dhe hartohej ne shkallen 1:5000; plani i qendres i pergatitur nga Florestano Di Fausto dhe plani per Tiranen e re pergatitur nga Kohler) dhe sidomos ne propozimet per elementet konkret te planit, si psh: zgjatime dhe zgjerime rruges, ruajtja ne maksimumin e mundshem e rrejtimit rrugor ekzistues, heqja e nje sere zgjatimesh dhe zgjerimesh qe bashkia i quante te kota; ne propozimet per krijimin e shesheve urbane, mos prishjen e banesave te vjetra, per siperfaqet e medha ne qender, te cilat sipas bashkise nuk duhej te lireshin ne dispozicion te administrates qendrore, pasi mund te perdoreshin per ndertime te tjera ne sherbim te qytetit.

Ky tension ndihej edhe ne faktin qe bashkia kerkonte te sigurohej mbi zbatimin e planit vetem pasi ky te ishte miratuar nga Keshilli i Ministrave dhe te ishte botuar ne Fletoren Zyrtare.

Mbi bazen e ketij plani u shenuan edhe kufijte e siperfaqes se qytetit te Tiranës (4.5 km²) dhe u konturuan zonat qendrore pergjate bulevardit (Rrugët e Durrës, Kavajës, Elbasanit etj) Nje procedure e tille e percaktimit te kufijve, deshmon se vendimet merreshin ne mungesen e orientimit te se ardhmes se qytetit.



Figura 1: Gjurma e planit te vitit 1929 mbi foton ajrore te Tiranes se sotme
(Burimi: Tirana Qyteti i Munguar)

Etapa e dytë perfshin periudhen nga 1939-1943, kur qytetet fillojne te shnderrohen (Tirana rithemelohe duke kaluar nga nje qytet organik ne nje qytet te organizuar);

Institucione te kohes - Autoritetet vendimmarrëse

Me poshte jane listuar disa nga institucionet me te rendesishme qe perfshiheshin ne procesin e hartimit dhe miratimit te planeve rregulluese dhe te studimeve urbanistike ne te gjithë vendin:

Keshilli Ministror, Ministria e Puneve Botore, Ministria e Punëve te Brendeshme, Zyra qendrore e Edilicjes dhe Urbanistikes se Shqipnis, Komisioni Qendror i Edilicjes dhe

Urbanistikes se Shqipnis, Keshilluesi i pare i Zyres se Urbanistikes, Bashkia e Tiranës, Insituti Gjeografik Ushtarak.

Vitet 1939-1943 edhe pse perfshihen ne harkun kohor brenda Luftes se Dyte Boterore, jane te mbushura me aktivitete te rëndesishme nga pikpamja e projekteve dhe vizioneve ne shkalle urbane per Tiranen. Si pasoje e pushtimit Italian, investime te kapitalit italian shtoheshin dita dites, keshtu qe u ndertuan nje sere objektesh publike, dhe objekte industriale sidomos ne Tirane.

Tashme projektet e urbanistikes te Tiranës dhe te qyteteve te tjera kryesore shqiptare duhet te perputheshin me vizionet e shkalles se nje perandorie shume me te madhe se vete Shqiperia. Plani rregullues i Tiranës (Nga Bosio te Lambertini dhe Poggi) i cili mori formen perfundimtare ne janar te 1943 u hartua ne dy faza.

Faza e pare ishte hartimi i planit ne vija te pergjithshme. Kjo faze perfundoi ne tetor te vitit 1939 dhe u miratua me ligjin Nr.71 te dates 07.03.1940. Ky plan u hartua nga zyra qendrore e Edilicjes dhe Urbanistikes se Shqipnis. Hartimi i planit u drejtua nga arkitekti italian Gherardo Bosio, ne rolin e Keshilluesit te Pare dhe Drejtorit te Zyres Urbanistike, i cili parashtrroi konceptet e planit. Ky plan ne vija te pergjithshme iu paraqit per miratim Komisionit Qendror dhe Keshillit ministror. Plani perfshinte Sistemimin e Shetitores se Perandorise (sot bulevardi “Deshmoret e Kombit”, qendren e qytetit Shetitoren “Viktor Emanuele” (Rr. Zog i pare), Shetitoren “Musolini” (Rr e Kavajes) dhe Shetitoren “Principe di Piemonte” (Rr e Duresit).

Faza e dyte e planit ishte Studimi i Planit Rregullues Definitiv, nen drejtimin e arkitektit projektues Ivo Lambertini dhe arkitektit keshillues Ferdinando Poggi, i cili u miratua me 31 janar 1943.

Rregullorja Edilicje sherbente per te diktuar normat e pergjithshme te menyres se ndertimit e te paraprinte marreveshjet midis fqinjeve, kushtet higjenike, sigurine e qytetareve, zbkurimin e qytetit etj. Regullorja Urbanistike sherbente per te percaktuar konkretisht ne menyre specifike normat dhe standartet si distancat midis objekteve, gjeressite e rrugeve dhe lartessite e kateve ne raport me to, vijat e ndertimeve etj.

*Plani mbartte dhe koncepte mjaft perparimtare ne drejtim te **Bashkepunimit me banoret ne lidhje me interesat e tyre dhe mundesite e kontributit te tyre per riparteritjen e qytetit bazuar ne parcelimin qe propozonte plani.***

Kjo duket qarte edhe nga pohimi ne relacion (Relacion i planit rregullues. Kapitulli : Konceptet dhe Drejtimi i studimeve te Planit Rregullues), ku qyteti pervec se nje organizem qe duhet te ishte i bukur, shihej edhe si nje organizem qe duhet te jetonte ekonomikisht/ sinonim i mireqenies dhe permisimit te kushteve te jeteses:

“Qyteti asht nji organizem ekonomik dhegjithsija e vet, rruga, shtepija, fabrika, zyra,transporte, asht nji vegël.....qellim i pare asht me bamë me leviz mire dhe ekonomikisht, duke mos u dukun vetem e bukur (relacion fq.14.... Relacion i planit rregullues. Kapitulli : Konceptet dhe drejtimi i studimeve te planit rregullues)”



Figura 2: Skema e përgjithshme e planit të vitit 1939-1943
(Burimi: Tirana Qyteti i Munguar)




Figura 3: Fotografi të Tiranës në periudhën kur hartohej plani 1939-1943
(Burimi: Tirana Qyteti i Munguar)

Momenti kur u punua dhe u hodhen idete per hartimin e Planit Rregullues te Tiranes gjatë viteve 1939-1943, eshte nga më të rendesishmit ne historine e konsolidimit urban te qytetit. Hartimi i ketij plani perbente qartazi nje moment frymezimi kur mendohej se shtysa drejt qytetit te madh ishte sinonim i mireqenies dhe permiresimit te kushteve te jeteses. Qyteti ishte vendi i mundesive te reja, i kapercimeve dhe i hopeve cilesore te jetes, sidomos per nje qytet si Tirana qe ishte ende ne fazat me femijore.

Etapa e tretë perfshin periudhen nga 1957- 1958 (Tirana nga shkaterrimi i qendres historike deri tek krijimi i parkut te liqenit)

Institucione te kohes – Autoritetet vendimmarrëse

Me poshte jane listuar disa nga institucionet me te rendesishme qe perfshiheshin ne procesin e hartimit dhe miratimit te planeve rregulluese dhe te studimeve urbanistike pjesore ne te gjithe vendin:

Ky organizim institucional arriti deri ne vitin 1991 dhe ndryshoi me ndryshimin e regjimit politik ne Shqiperi.

Kryesia e Keshillit te Ministrave:

Kjo kryesi ishte organi me i larte qe miratonte planet perpara se kryeministri ti firmoste ato.

Komisioni Shteteror i Projekteve te Ndertimit – ky komision mund te konsiderohet si ekuivalent i atyre qe pas viteve 90- te u quajten Keshilla te Rregullimit te Territorit, te cilat funksiononin si ne nivel qendror ashtu edhe ne nivel vendor.

Anetaret e Komisionit Shteteror te Projekteve ne Ndertim

Per mbledhjen e Planit rregullues te hartuar ne vitet 1957- 1958 anetaret e komisionit ishin si me poshte: Koco Theodhosi, Aleks Verli, Ciril Pistoli, Shinasi Dragoti, Gani Strazimiri, Gjovalion Gjadri, Salih Angoni, Vasil Pistoli, Pupo Shyti.

Merrnin pjese si te ftuar: Kryetar i komitetit Ekzekutiv te qytetit te Tiranes Rifat Dedja, Nenkryetari Xhavit Sallaku, Drejtori i Zyres Urbanistike te Tiranes Remzi Skenderi, si dhe Vasil Nauni dhe Llazar Kule; Merrnin pjese edhe autoret e planit rregullues arkitekti Dimo Angjellov dhe Arkitekti Misto Mele.

Ministria e Ndertimit- pas viteve 90- te disa nga funksionet e kesaj jane kryer nga ministri me emerime te ndryshme si : Ministria e Puneve Publike dhe Transportit, apo Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Ndermarrja Shteterore e Projektit (N.SH) – Ky institucion kishte rolin e institutit te projektimit, aktualisht eshte transformuar ne Agjensine Kombetare te Planifikimit te Territorit, AKPT.

Plani i vitit 1957-1958 hartohet ne kushte te nje sfoni ideologjik qe e veshtiresonte shume punen projektuese, sidomos ne drejtim te shkembimit te eksperiencave dhe marrjes se vendimeve pertej vendeve lindore.

Keshtu, pas periudhes se mbreterise ku dominoi ndikimi i forte i arkitekteve austriake dhe italian, periudhes se pushtimit italian ku dominoi fuqishem ndikimi i arkitektures dhe urbanistikes italiane (me te njetat tipare sikuresse edhe brenda vete Italise), ne fazen e ketij plani dominoi ndikimi i shkolles se vendeve te Bllokut Lindor: fillimisht asaj ruse me projektidene e planit ne vitin 1953 e me pas asaj bullgare me planin e filluar ne vitin 1957, dhe miratuar ne 1958.

Përpara miratimit Projektideja e Planit të Përgjithshëm rregullues u shqyrtua nga Këshilli Teknik, si dhe nga Byroja e Komitetit të Partisë dhe Komiteti Ekzekutiv i qytetit të Tiranës. Studimi i planit parashikonte edhe paraqitjen e tij ndaj popullit përmes Komitetit Ekzekutiv. Sikurse pohoet, vërejtjet u pasqyruan në projektidene që u paraqitën për miratim në Komisionin Shtetëror për Projektet në Ndërtim.



Figura 4: Fotografi nga Tirana, 1962
(Burimi: Rr e Durrësit, Tirana Qyteti i Munguar)



Figura 5: Fotografi nga Tirana midis viteve 1957-1961
(Burimi: Rr e Kavajës, Tirana Qyteti i Munguar)

Etapa e katërt 1985-1989 (Tirana parandien shperthimin e madh, propozimi per zgjatimin e bulevardit, krijimin e pese unazave dhe tre parqeve periferike)

1960- 1989 veteizolimi i plote i Shqiperise ne kontrast me manifestimet per emancipim shoqeror ne arenen nderkombetare.

Institucione te kohes – Autoritetet vendimmarrëse

Kryesia e Keshillit te Ministrave:

Kjo kryesi ishte organi me i larte qe miratonte planet perpara se kryeministri t'i firmoste ato.

Komisioni Shteteror i Projekteve te Ndertimit.

Anetaret e Komisionit Shteteror te Projekteve ne Ndertim

Ministria e Ndertimit

Plani i Pergjithshem Rregullues i vitit 1985-1989 u hartua nga Instituti i Studimeve dhe Projekttimeve te Arkitektures dhe Urbanistikes me porosi te Komitetit Ekzekutiv Tirane.

Ne Shqiperi, ne fund te viteve 80 –te vetem 35 % e popullsise jetonte ne zonat urbane. Ne lidhje me urbanizimin Shqiperia ndiqte politiken e kontrollit te popullsise duke detyruar shpesh levizjen ne kah te kundert, nga qyteti ne fshat. Kjo politike frenuese ne lidhje me urbanizimin shkaktoi edhe levizjen masive te popullsise ne drejtim te qyteteve menjehere pas heqjes se pengesave ideologjike.

Levizjet e viteve 60 qe shkonin paralel edhe me ndryshimet e fenomeneve te tjera si rritja e moshes mesatare, rritja e rolit te gruas, apo ndryshimi i konceptit te familjes, do te benin qe ne prag te viteve 70, referencat sociale dhe vlerat kulturore te shoqerise te ndryshonin.

Liria, ndergjegjesimi dhe pjesemarrja e individit ne proceset sociale, politike dhe nderpersonale po behej thelbesore.



Figura 6: Fotografi nga Tirana prag viteve 90-te
(Burimi: Rr Luigj Gurakuqi – kantier ndertimit; Tirana Qyteti i Munguar)

Keshtu ne perputhje me kete, disa arkitekthe nisen nje proces kompleks, i cili i shihte PERDORUESIT E ARDHSHEM SI PROTAGONISTE AKTIVE TE PROCESIT TE VENDIMMARRJES.

Sikurse shkruan edhe Saggio, (2010- Architettura e modenita, dal Baauhous alla rivoluzione informatica, Roma) rezultati i kesaj suate ne debatin arkitektonik te viteve 70-te ishte : “ARKITEKTURA E PJESEMARRJES” .

Keto kerkime lidheshin me zhberjen e pozicionimit dogmatik qe shihte tek arkitekti te vetmen pike qendrore te vendim marrjes. Kjo qasje kishte rezultuar ne shkeputje totale mes realitetit te jetes dhe deshirave konkrete te banoreve.

Ne fund te kesaj periudhe 1985-1989, prej afro 45 vite rregjimi totalitar ne Shqiperi, u kuptua qarte se arkitektura dhe urbanistika jo vetem qe nuk kushin krijuar nje ambient me te mire, por perkundrazi, ato kishin materializuar ne hapesine shtypjen, mungesen e identitetit dhe zbrazetine shpirtore qe karakterizonte te gjithë jeten e vendit.

Etapa e peste pas viteve 1990 (Shperthimi i informalitetit, levizja drejt qendres)

Shqipëria e pasviteve '90-te pasqyron një tranzicion të gjatë e kompleks, si rezultat i ndryshimeve të ndodhura gjatë kalimit nga një sistem ekonomik i centralizuar, në një ekonomi të mbështetur në tregun e lirë. Shoqëria paskomuniste përjetoj ndryshime shumë të mëdha ekonomike dhe sociale, shpesh herë traumatike, të shoqëruara me degradimin/shpërbërjen e sistemit ‘totalitarist’ të planifikimit dhe të pronës shtetërore.

Në pak vite u çmontuan simbolet e autoritetit e të kontrollit. Transformimi i thellë kishte, padyshim, implikime të shumta ekonomike, sociale e politike për shoqërinë paskomuniste shqiptare, dhe kjo reflektohet ende sot jo vetem në strukturën e ekonomisë, por edhe në zhvillimet urbane.

Keto vakume si edhe mungesa e komunikimit dhe nderveprimit per nje kohe te gjate me arritjet nderkombetare, jane pjese e shkaqeve perse edhe sot ne shume raste arkitektura dhe urbanistika ne Shqiperi , vazhdojne te mbeten ne nivelin e klithmave provinciale pavaresisht shprehjeve me cipe te kohes. Arkitektura dhe urbanistika shqiptare do te behen me inteligjente vetem kur ato te perfshihen ne sfidat e verteta qe shtron koha ne lidhje me zhvillimin ne teresi, jo vetem ne rrafsh lokal por edhe ate global. (Dhamo. S, Thomai. Gj, Aliaj. B, 2016 fq.293)

Mirëkuptimi në komunikim eshte themeli i nje procesi transformues. Qeverisja nenkupton strukturat dhe proceset në shoqëri që hartojnë dhe aplikojnë në mënyrë autoritative politika dhe rregulla. Pra,qeverisja nenkupton një tërësi strukturash dhe procesesh në shoqëri, të cilat hartojnë dhe zbatojnë në mënyrë autoritative politika dhe rregulla.

Një shoqëri, si një rrjet marrëdhëniesh njerëzore përfshin tre elemente interaktivë:

- idete
- institucionet
- objektet materiale.

Pra, shoqëria rezulton si një rrjet marrëdhëniesh njerëzore të kompozuar në trajtën e ideve, institucioneve dhe sendeve materiale.

2.3 Informaliteti

Etapa e gjashte pas viteve 1997 (Rritje e informalitetit qe kulmoi ne vitin 1997, si pasoje e krizes ekonomike)

Kolapsi i pare: Pas viteve 1990 – Shperthimi i informalitetit, si pasoje e :

- nevojës për banim/banësë
- nevojës për një të ardhme sa më të mirë (lëvizja drejt qendrës)

Kolapsi i dytë: Pas viteve 1997 – Rritje e informalitetit qe kulmoi ne vitin 1997, si pasoje e :

- krizës ekonomike

Vala e informalitetit u shoqërua me ndryshime të mëdha demografike. Vihet re kalimi nga një QYTET i mirë planifikuar në një QYTET qe rritet në cepat e tij, bazuar në “Inteligjencën Komune” Vala e informalitetit mund të klasifikohet në 2 kategori:

- a. Informalitet peri urban (ku flukset e banorëve tentuan të zaptinin hapsirat bujqësore rreth QYTETIT, të organizuar sipas vijës familjare ose vijave rurale)
- b. Informalitet urban (ku banorët tentuan të shtonin në godinat/apartamentet e tyre individuale hapsirat shtesë)



Figura 7: Gjurme të informalitetit urban në Shqipëri
Transformimet e territorit në Shqipëri 1990- 2015. Burimi: Arkiva Co-Plan

2.4 Ndikimi i reformes administrative / territoriale ne hartimin e politikave te reja

Etapa e shtate pas reformes territoriale 2014-2015, vihet re shumefishimi i popullsisë ne qytetet kryesore (Tirana eshte 4-fishuar ne raport me 25 vitet e meparshme).

Zhvillimet arkitektonike dhe urbane në Shqipëri vazhdojnë të gjenerojnë ndjeshmëri të ndryshme, negative dhe pozitive.

Duke supozuar si racionale dhe jo të vetëkontrollueshme sjelljen e individit, roli i shtetit për të influencuar në sjelljen e individit në raport me interesin publik është i pazëvendësueshëm. Në këtë kontekst, hartimi i planeve urbane për të orientuar zhvillimin dhe investimet nuk është një luks, por një domosdoshmëri. Mungesa e alternativave për investime (përfshirë frikën nga krizat financiare), varësia nga remitancat dhe kapitali njerëzor i ulët i shtyjnë individët të investojnë në pasuri të paluajtshme në mënyrë joefektive.

Sfida qëndron në atë se si do të stimulohen proceset transformuese në nivel komuniteti, lagjeje, qyteti, që te na mundësojnë një zhvillim të qëndrueshëm urban.



Figura 8: Reformën administrative - territoriale 2014-2015
(Burimi: AKPT)

Kjo reforme kërkon domosdoshmërisht “Forcimin e kapaciteteve institucionale të autoriteteve lokale për të menaxhuar më mirë potencialet që administrojnë, duke garantuar një zhvillimin ekonomik e rajonal të qëndrueshëm, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të këtyre zonave si dhe gjenerimin e mundësive të reja për punësim”

Reformë me ndikim të gjerë

Qeveria shqiptare me 2014-2015, hartoi me sukses reformën administrative-territoriale duke organizuar qeverisjen vendore në 61 bashki. Organizimi i ri territorial synon fuqizimin e bashkive duke rritur kapacitetin e tyre për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për qytetarët dhe duke rritur efikasitetin e menaxhimit të burimeve të tyre

Rritja e efikasitetit dhe mirëqeverisjes në nivel vendor

Reforma administrative-teritoriale pritet të çojë në përmirësimin e mirëqeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve publike më efikasitet nga qeveritë vendore; mbledhjen më efektive të taksave dhe tarifave nga to; mundësi më të mira për të promovuar dhe nxitur zhvillimin ekonomik lokal të qëndrueshëm. Reforma administrative territoriale është pa dyshim një nga reformat kryesore të vendit me përfitime të shumëllojshme. Disa nga përfitimet kryesore të kësaj reforme janë:

Rritja e efikasitetit në drejtim të përdorimit të fondeve publike

Shumë fonde të cilat shkonin për të financuar shpenzime pagash apo shpenzime operative tani ka mundësi të kanalizohen tani në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët si dhe në investime aq shumë të nevojshme. Njësitë më të mëdha do të kenë mundësi të hartojnë strategji më të mira për zhvillim ekonomik në territorin e tyre për shkak të përqendrimit më të madh të burimeve ekonomike, natyrore, financiare dhe njerëzore, gjë të cilën njësitë e vogla për shkak të limiteve të tyre nuk mund ta arrijnë. Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët për shkak të ekspertizës si furnizimi me ujë apo kanalizimet dhe trajtimi i ujërave të përdorura apo edhe trajtimi i mbetjeve të ngurta, planifikimi i territorit dhe hartimi i planeve urbanistike etj.

Avantazhet dhe disavantazhet

Reforma ofron mundësi të shumta për Bashkitë në Shqipëri për të performuar më mirë në punën e saj duke realizuar më mirë detyrimet ndaj qytetarëve. Reforma ka disavantazhe, por ajo kërkon një shkallë të lartë vizioni dhe përgjegjësie nga drejtuesit vendorë, që mundësitë që kjo reformë ofron të shfrytëzohen në mënyrë maksimale.

Përfitimi i banorëve

Banorët me shtrirje më të madhe do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejt me shumë investime në rrjetet e ujësjellësive, kanalizimeve, shkolla, rrugë etj si dhe një përmirësim të shërbimeve bazë.

Qytetarët dhe të zgjedhurit e tyre nuk janë pyetur për mënyrën sesi ata mendojnë që të realizohet ndarja territoriale. Ky është qëndrimi i krerëve të njësive vendore, të cilët kanë apeluar për zhvillimin e një referendumi për ndarjen territoriale.

KAPITULLI 3

3 Pjesëmarrja e qytetareve si pjesë përberëse e demokracisë pjesëmarrëse

3.1 Historiku i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje

Pjesëmarrja e qytetarëve është një temë pa fund, dhe rëndësia e kontributi i saj për një demokraci të shëndoshë dhe të zhvilluar është shumë e madhe.

Pjesëmarrja qytetare mund të shihet si një proces në të cilin shqetësimet, nevojat, vlerat, pritshmëritë dhe problemet e qytetarëve merren parasysh në procesin vendimarrës të qeverisë.

Pjesëmarrja qytetare është një proces komunikimi i dyanshëm mes qeverisë dhe qytetarëve me qëllim marrjen e vendimeve më të mira të mbështetura nga publiku dhe nxitjes e thithjes së mireqenies së popullsisë e reduktimin e varfërisë.

Pjesëmarrja civile përfshin tre elemente të nderlidhur me njëri – tjetrin:

- Qeveri të hapur dhe transparente, duke përfshirë qytetarët në teresinë e aktivitetit të saj dhe procesin e vendimmarrjes;
- Dhenie informacioni të qendrueshëm dhe të vazhdueshëm nga qeveria drejt qytetarëve dhe anasjelltas;
- Menyra sa më efektive për të informuar qytetarët të kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre për të qenë pjesëmarrës si partnerë të barabartë.

Pjesëmarrja qytetare është kombinim i këtyre tre elementeve, në mënyrë që planet e qeverisë të zhvillohen dhe zbatohen në bashkëpunim, për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave dhe dëshirave të qytetarëve. (Chetwynd and Chetwynd, 2001)

Ka forma të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve që njihen në literaturë dhe në praktikë; duke filluar nga konsultimet e përgjithshme dhe dërgimi i komenteve në projektligje përmes postës elektronike e deri tek negociatat e drejtpërdrejta duke u bazuar në marrëveshjet strategjike për partneritet, nga debatet publike e deri tek trupat e udhëhequra nga organizatat e shoqërisë civile.

Sidoqoftë, të gjitha këto janë të bazuara në të drejtën për qasje në informata, e cila është kusht bazë për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve.

Në vijim do të paraqiten disa modele të pjesëmarrjes së qytetarëve, që janë pjesë e rëndësishme e kornizës së përgjithshme institucionale të bashkëpunimit, duke marrë parasysh se ligjet dhe rregulloret e tjera të përgjithshme shpesh janë instrumentet kryesorë të artikullimit dhe zbatimit të politikave publike.

Në nivelin e pjesëmarrjes aktive, janë identifikuar instrumente të ndryshme, siç janë: këshillat, grupet drejtuese të marrëveshjeve të bashkëpunimit/kompakteve, por edhe

pjesëmarrës të udhëhequr nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat ofrojnë një kornizë të mirë organizuar për çështjet publike.

Format e pjesëmarrjes do të duhej të ekzistonin jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë lokal, në mënyrë që pushteti lokal të ketë mundësinë të punojë më afër me qytetarët dhe t'i prekë problemet që drejtpërsëdrejti ndikojnë në jetën e tyre.

Ideja kryesore e demokracisë pjesëmarrëse.

Pjesëmarrja në procese vendimmarrëse do të thotë mundësi për qytetarët, Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) dhe palët e tjera të interesuara për të ndikuar në zhvillimin e politikave dhe ligjeve të cilat i prekin ata.

Pjesëmarrja e qytetarëve është pjesë përbërëse e demokracisë pjesëmarrëse, e cila pasqyron demokratizimin e marrëdhënieve politike pas krizës në qeverinë përfaqësuese dhe pas largimit të regjimeve autoritative në disa vende të Europës Jugore (Spanjë, Portugali, Greqi).

Mirëpo, është e rëndësishme të theksohet që demokracia pjesëmarrëse nuk i pezullon kompetencat kushtetuese dhe ligjore të përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në procedurën e miratimit dhe zbatimit të ligjeve, si dhe të instrumenteve të politikave publike, por për më tepër u'a mundëson autoriteteve t'i zbatojnë këto kompetenca në mënyrë më efikase. Konsultimet mes autoriteteve dhe palëve të interesuara ndihmojnë në trajtimin e disa mangësive në përfaqësimin politik në demokracitë moderne parlamentare.

Organizatat e shoqërisë civile luajnë rol të dyfishtë në këtë proces: në njërën anë, OSHC-të ua mundësojnë qytetarëve të organizohen dhe të shprehin interesat e tyre legjitime në mënyrë më të efektshme, ndërsa në anën tjetër, ato janë gjithashtu palë legjitime në proces (së paku për atë sa disa nga të drejtat njerëzore, nga të cilat rrjedh e drejta e pjesëmarrjes gjithashtu vlejnë edhe për OSHC-të (p.sh. liria e fjalës, liria e asociimit, liria e qasjes së papenguar në informata).

Përparësitë dhe sfidat e ligjbërjes pjesëmarrëse

Demokracia pjesëmarrëse e bën të mundshme pjesëmarrjen e vazhdueshme qytetare në procesin politik dhe i kontribuon punës së hapur dhe transparente të pushtetit ekzekutiv dhe përfaqësues.

Për më tepër, pjesëmarrja mund të ndihmojë drejt:

- Krijimit të politikave dhe ligjeve të drejta, të cilat pasqyrojnë nevojat e vërteta, të pasuruara me përvojë dhe ekspertizë shtesë;
- Lehtësimit të dialogut ndërsektorial dhe arritjen e konsensusit;
- Zbatimit të zgjidhjeve më largpamëse dhe gjithëpërfshirëse;
- Sigurimit të legjitimitetit dhe të përputhshmërisë të rregulloreve të propozuara;
- Uljes së kostos, në mënyrë që palët mund të kontribuojnë me resurset e veta;
- Rritjes së partneritetit, pronësisë dhe përgjegjësisë në zbatim;
- Fuqizimit të demokracisë – parandalimin e konfliktit mes grupeve të ndryshme dhe mes qytetarëve dhe qeverisë, si dhe rritjen e besimit në institucionet publike.

Megjithatë, duhet të theksohet se sigurimi i një procesi pjesëmarrës të ligjbërjes ka gjithashtu sfidat dhe pengesat e veta.

Nga ana e Qeverisë:

- Konteksti politik mund të mos jetë përkrahës për përfshirjen e qytetarëve;
- Organet dhe përfaqësuesit qeveritarë mund të mos i kuptojnë sa duhet përparësitë e pjesëmarrjes qytetare;
- Mungesa e mekanizmave transparent dhe efikas të pjesëmarrjes qytetare – vonesa në miratimin e kornizës së duhur ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Mungesa e kornizës institucionale dhe e kapacitetit për proceset pjesëmarrëse;
- Mund të mos jetë e qartë se kush duhet të konsultohet apo të angazhohet;
- Qeveria mund të konsultohet vetëm pjesërisht, me të ashtuquajturat organizata “miqësore” – mungesa e standardeve dhe procedurave të përgjithshme lidhur me emërimin e përfaqësuesve të shoqërisë civile;
- Qeveritë mund të jenë nën presion të afateve kohore për të miratuar legjislacion të caktuar;
- Proceset pjesëmarrëse janë të kushtueshme; ato kërkojnë investime në organizmin e takimeve, hartimin e komenteve dhe në ofrimin e informatave për rezultatet e komenteve.

Nga ana e qytetarëve dhe e palëve të tjera me interes:

- Qytetarët dhe palët e tjera të interesuara mund të mos i kuptojnë mjaftueshmërisht çështjet për të cilat zhvillohen konsultime;
- Ata mund të mos kuptojnë nevojën e bashkëpunimit me Qeverinë;
- Ata mund të mos kenë shkathtësi të duhura të komunikimit dhe të lobimit për të shprehur mendimin e tyre;
- Ata mund të mos kenë kapacitet të mjaftueshëm për të reaguar shpejtë ndaj njoftimeve të Qeverisë dhe për të marrë pjesë në konsultime në mënyrë profesionale;
- Ata mund të mos kenë zgjidhje konkrete për probleme, por vetëm të kritikojnë propozimet e qeverisë;
- Partnerët strategjikë të Qeverisë mund të mos pranohen dhe të mos jenë në gjendje të përfaqësojnë mendimet dhe interesat e sektorit;
- Mungesa e koalicionëve, rrjeteve në nivel lokal dhe shtetëror për të artikuluar mendimet në mënyrë më efektive.

Me rastin e krijimit të standardeve të duhura për pjesëmarrje në një vend, është me rëndësi të shqyrtohen jo vetëm mundësitë, por edhe sfidat në mënyrë që të zbatohen mekanizmat e duhur për trajtimin dhe tejkalimin e këtyre sfidave.

3.2 Format e pjesëmarrjes

Intensiteti i pjesëmarrjes së qytetarëve

Në vitin 1969 Sherry Arnstajni (Arnstein) krijoi idenë e “Shkallëve të pjesëmarrjes”, e cila funksionin në vazhdimësi, duke filluar nga më të shfrytëzuarit dhe të pafuqishmit e deri te ata që më së shumti kanë kontroll dhe fuqi.

Në shkallën e Arnstajnit propozohen tetë ‘nivele’ të pjesëmarrjes, në kuadër të tri kategorive
-qytetaria pasive
-krijimi i imazhit të qytetarisë aktive
-qytetaria aktive
paraqet tri nivele të ndryshme të bashkëpunimit mes qytetarëve dhe autoriteteve në formulimin e politikave publike.

Nje dimension i rendesishem i pjesemarrjes qytetare eshte menyra se si ndertohet marredhenia ndermjet institucioneve dhe aktoreve te ndryshem perms shperndarjes se autoritetit. Ketij dimensionit i kushtoi vemendje sociologjia amerikane e siperpermendur Shery Arnstein, e cila qe ne 1969 publikoi hulumtimin mbi rolin historik te pjesemarrjes qytetare ne procesin e vendim marrjes.

Arnstein argumentoi se pjesemarrja qytetare eshte nje “term percaktues per fuqine e qytetareve” duke qene se ajo duhet te shkoje pertej thjesht rolit vezhgues te qytetareve dhe pjesemarrjes joaktive, sepse publik nuk eshte aktor pasiv , por nje agjent qe ka fuqine te ndryshoje dhe influencoje menyren se si menaxhohen ceshtjet publike. Keshtu , eshte e qarte se pjesemarrja qytetare nuk eshte thjesht pjese e pershkrimit te marreveshjeve te vecanta institucionale per vendimmarrjen, por n je pjese e autoritetit i cili realisht merr vendimet.

Sipas shkencetareve politike si Robert Dahl, demokracite duhet te sigurojne mundesi te barabarta dhe te pershtatshme per pjesemarrjen e qytetareve.

Keto mundesi duhet t’u garantojne qytetareve:

- a. Te vendosin ceshtjet prioritare ne axhende
- b. Te shprehin pikepamjet e tyre mbi keto ceshtje
- c. Te ushtrojne autoritet (nepermjet votimit ose ndonje forme tjeter)

Te tria keto te drejta jane te sanksionuara ne Traktatin e Lisbones .

Qasja në informata – është e drejta e parë dhe themelore që përshkon tërë procesin e pjesëmarrjes. Ky është një proces njëkahësh, ku informata rrjedh prej autoriteteve tek qytetarët. Ky lloj i ndërveprimit ofron qasje pasive në informata në bazë të kërkesës së qytetarëve dhe masa aktive të Qeverisë për shpërndarjen e informatave qytetarëve (p.sh. kërkesa për dokumente zyrtare, Gazeta Zyrtare, faqe të internetit të autoriteteve).

Konsultim –Kjo është marrëdhënie e dyanshme ku qeveria fton qytetarët t’i shprehin mendimet, komentet dhe pikëpamjet për një dokument të caktuar. Kjo është një mënyrë reaguese e pjesëmarrjes, ku qytetarët përfshihen sepse qeveria e kërkon këtë (p.sh.projektligje).

Pjesëmarrja aktive – Ky është një nivel më i lartë i marrëdhënies dykahëshe, ku qytetarët janë të përfshirë në mënyrë aktive në propozimin e alternativave të politikave dhe në formësimin e dialogut të politikave. Kjo mund të përshkruhet si situatë ku përfaqësuesit e qytetarëve ndajnë karriqe në tryezë me përfaqësuesit e qeverisë (p.sh. partneriteti strategjik, anëtarësimi në grupe punuese).

Kodi i praktikës së mirë i Këshillit të Europës (KE) gjithashtu thekson dialogun si një formë aktive e pjesëmarrjes dhe si një parakusht për marrëdhënie bashkëpunuese. Aty kërkohet

“komunikim i dyanshëm, që bazohet në interesa të ndërsjella dhe mundësisht në objektiva të përbashkëta me qëllim të sigurimit të shkëmbimeve të rregullta të pikëpamjeve.”

Nivelet e pjesëmarrjes së qytetarëve

Procesi i pjesëmarrjes mund të zbatohet në më shumë se një nivel:

- Në nivele më të larta, ku zhvillohen strategjitë, qasjet e përgjithshme dhe konceptet (p.sh. politikat dhe dekretet)
- Në planifikim të aktiviteteve dhe në zhvillimin të programeve
- Në projekte konkrete

Format konkrete të pjesëmarrjes së qytetarëve ne procesin e vendim marrjes:

Ekzistojnë mekanizma dhe modele të shumta për lehtësimin e bashkëpunimit, të cilat përfshijnë OShC-të në procesin e vendimmarrjes.

Disa instrumente vijuese, të grupuara në bazë të tri niveleve të bashkëpunimit:

Qasja në informata	Konsultimet	Pjesëmarrja aktive
Faqja e internetit (Pyetjet e shpeshta)	Seancat publike dhe panelet për pyetje dhe përgjigje	Organet ndërsëktorale (këshillat, bordet, komisionet, organet këshillëdhënëse)
Lista e postës elektronike, njoftimet me postë elektronike	Takimet publike dhe diskutimet	Organet e udhëhequra nga OShC-të
Tabela e lajmërimeve	Kërkesa për komente dhe konsultime përmes internetit	Grupet drejtuese të marrëveshjeve të bashkëpunimit/Kompakteve
Takimet publike informative	Peticionet	Partneriteti strategjik
Mundësia për inspektimin e dokumenteve zyrtare	Kontakte kyce qeveritare	Portalet qytetare
Transmetime nëpërmjet internetit	Seminaret e ekspertëve	Bashkëhartimi
Fushatat, lobimi	Seminaret për ngritjen e kapaciteteve dhe për trajnim	
Hulumtimet		

Tabela 3.1: Tri nivelet e bashkëpunimit

3.3 Konteksti evropian dhe boteror

"Shoqata e Planifikimit Amerikan (APA) siguron udhëheqjen në zhvillimin e komuniteteve vitale, duke mbrojtur përsosmëri në planifikimin komunitar, duke promovuar edukimin dhe fuqizimin e qytetarëve si dhe sigurimin dhe mbështetjen e nevojshme për të përmbushur sfidat e rritjes dhe ndryshimit. "

APA gjithashtu pohon se : Kur zyrtarët qeveritarë, liderët e biznesit dhe qytetarët të vijnë së bashku për të ndërtuar komunitete që rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve, ky konsiderohet PLANIFIKIM.

Bashkepunimi ne Planifikim, për të përmirësuar mirëqenien e njerëzve dhe të tyre duke krijuar një ambjent më të përshtatshëm, të drejtë, të shëndetshëm, efikase, dhe vende tërheqëse për generatat e tanishme dhe të ardhshme.

Planifikimi mundëson udhëheqësit civile, bizneset dhe qytetarët të luajë një rol domethënës në krijimin e komuniteteve që përmiresojnë jetën e njerëzve.

Bashkepunimi i mirë ndihmon në krijimin e komuniteteve që ofrojnë zgjedhje me të mira për ku dhe se si njerëzit të jetojnë. Planifikimi i ndihmon anëtarët e komunitetit të parashikojnë drejtimin komuniteti i tyre se si të rritet dhe do të gjejnë bilanci e duhura zhvillimin, shërbimet themelore, mbrojtjen e mjedisit, dhe për ndryshimet e reja.

"There is still confusion over how to think about planning"
(Campbell & Fainstein, 2003, p. 143).

"If Planning Is Everything, Maybe It's Nothing." (Wildavsky, 1973)

"If Planning Includes Too Much, Maybe It Should Include More." (Lucy, 1994)

Banfield (1961) explains the problem of city planning in America as:

American cities seldom make and never carry out comprehensive plans. Plan making is with us an idle exercise, for we neither agree upon the content of a 'public interest' that ought to override private ones nor permit the centralization of authority needed to carry a plan into effect if one were made. (p. 263)

Bull (2007) writes, "“Think globally, act locally,’ the adage coined in the 1970s, expressed the importance of linking both global and local domains when making decisions about the environment” (p. 208).

Dokumentet kryesore te pjesemarrjes se qytetareve ne Evrope.

Rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave dhe të ligjeve është pranuar në masë të gjërë. Organizatat më të mëdha ndërqeveritare kanë hartuar dokumente dhe kanë krijuar modele për përkrahjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare. Edhe pse disa nga këto dokumente nuk janë ligjërisht obligative, ato paraqesin standardet, parimet dhe praktikën më të mira, të cilat duhet të merren parasysh me rastin e nismave të ndryshme në nivel shtetëror.

Bashkimi European

Komisioni European në vitin 2001 ka hartuar Letrën e bardhë për qeverisjen europiane i cili, në mes të tjerash, ka pasur për qëllim fuqizimin e kulturës së konsultimit dhe të dialogut në nivel të BE-së, dhe, kështu, të rrisë legjitimitetin e vendimeve. Në Dokument theksohen pesë parimet e ‘qeverisjes së mirë’: transparencja, pjesëmarrja, efektshmëria dhe koherenca, të cilat jo vetëm se “mbështesin demokracinë dhe sundimin e ligjit në shtetet anëtare të BE-së, por ato vlejnë për të gjitha nivelet e qeverisë - global, european, shtetëror, regjional dhe lokal”. Përmes Letrës së bardhë rekomandohen ndryshime në disa drejtime, dhe obligohet Komisioni European që të ndërmerr veprime për zbatimin e tyre. Si një prej rezultateve, në vitin 2002 Komisioni European miratoi Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultimin e palëve të interesuara (Parimet dhe standardet minimale të KE-së). Dokumenti thekson rëndësinë e ofrimit të dokumenteve të qarta për konsultim, konsultimin e të gjitha grupeve relevante të synuara, lejimin e kohës së mjaftueshme për pjesëmarrje, publikimin e rezultateve dhe informimin e pjesëmarrësëve me rezultatet e komenteve të tyre.

Qasja pjesëmarrëse e politikëbërjes dhe ligjëbërjes në nivel të BE-së dhe në shtetet anëtare gjithashtu është rrënjësuar edhe në Traktatin e Lisbonës.

Më konkretisht, neni 10 parasheh që: “çdo qytetar ka të drejtë në pjesëmarrje në jetën demokratike të BE-së; vendimet do të merren në mënyrë sa më transparente dhe sa më të afërt me qytetarin.”

Edhe më me rëndësi është të ceket se Parlamenti European miratoi rezolutën për perspektivat e Zhvillimit të dialogut civil në kuadër të Traktatit të Lisbonës në vitin 2009.

Dokumentet kryesore të pjesëmarrjes së qytetarëve në Europë

Rezoluta fuqizon rëndësinë e konsultimeve dhe të ftesave për institucionet e BE-së që të miratojnë udhëzime obliguese lidhur me emërimin e përfaqësuesve të shoqërisë civile, metodat e organizimit të konsultimeve dhe financimin e tyre, dhe kërkesat ndaj tyre për të mirëmbajtur regjistrat e OShC-ve aktive. Më tej, rezoluta thërret institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare të saj, që të shfrytëzojnë në maksimum dispozitat ligjore dhe praktikën më të mira për të “rritur dialogun me qytetarët dhe OShCtë”, dhe në mënyrë specifike, në ato regjione dhe sektorë, ku dialogu nuk është plotësisht i zhvilluar.

Në rezolutë gjithashtu parashihet se dialogu me qytetarët në të gjitha nivelet kërkon resurse të caktuara financiare dhe, rrjedhimisht, fton të gjitha palët me interes dhe organet përgjegjëse të sigurojnë financimin e duhur të atij dialogu.

Këshilli i Europës

Çështja e pjesëmarrjes është trajtuar në disa rekomandime të Këshillit të Europës.

Rekomandimi CM/Rec (2007): “Mekanizmat qeveritarë dhe agjencitë duhet të sigurojnë pjesëmarrje të efektshme dhe pa diskriminim të OJQ-ve në të gjitha nivelet lidhur me dialogun dhe konsultimet për objektivat dhe vendimet e politikave publike. Kjo pjesëmarrje duhet të sigurojë shprehjen e lirë të llojshmërisë të mendimeve të njerëzve përkitazi me funksionimin e shoqërisë. Kjo pjesëmarrje dhe bashkëpunimi duhen të mbështeten duke siguruar ofrimin e informatave zyrtare apo qasjen e duhur në to; OJQ-të duhet të konsultohen gjatë hartimit të legjislacionit dhe të akteve nënligjore, që ndikojnë në statusin, financimin dhe sferat e funksionimit të tyre.

Edhe pse nuk ka karakter obligues, gjithashtu vlen të përmendet Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes (2009), përmes të cilit përcaktohen parimet e përgjithshme, udhëzimet, instrumentet dhe mekanizmat për pjesëmarrje të qytetarëve, me qëllim të zbatimit të tij në nivel lokal, regjional dhe shtetëror.

3.4 Praktikrat me te mira te pjesemarrjes dhe vendimmarrjes

Procedurat dhe rregullat e pjesëmarrjes së qytetarëve mund të rregullohen përmes dokumenteve obliguese ligjore (ligje, rregullore), siç është rasti me Hungarinë, dhe përmes dokumenteve që nuk kanë karakter obligues ligjor (kode, standarde), siç është rasti me Anglinë dhe Austrinë. Megjithatë, shumica e vendeve përdorin të dy instrumentet (për shembull, Kroacia), me qëllim që të sigurohet një fleksibilitet për palët me interes, në rastet kur ky fleksibilitet konsiderohet i arsyeshëm.

Në disa vende, e drejta e pjesëmarrjes është e rregulluar madje edhe me Kushtetutë (siç është rasti me Hungarinë dhe Kroacinë). Megjithatë, në shumë vende të tjera, kjo çështje nuk trajtohet në mënyrë specifike në Kushtetutë, por rrjedh nga të drejtat e tjera (p.sh. nga liria e shprehjes, liria e bashkimit, e drejta për referendum).

Anglia

Anglia është një demokraci e vjetër, është kampione e praktikave të mira për pjesëmarrjen qytetarëve, si në aspektin e instrumenteve obliguese ligjore, ashtu dhe të atyre joobliguese.

Çka është më e rëndësishme, Marrëveshja për marrëdhëniet mes Qeverisë dhe sektorit të vullnetarizmit e të komunitetit (“Kompakti”) – një marrëveshje mes Qeverisë dhe shoqërisë civile – është shpallur në vitin 1998 në nivel të shtetit dhe është konsideruar si instrument në lëvizjen e shumë çështjeve nga margjinat e politikave të qeverisë dhe çuarjen e tyre përpara (p.sh. periudhat 12 javore të konsultimeve). Në bazë të përvojave, Kompakti i ri në nivel shteti është miratuar në dhjetor të vitit 2009. Në bazë të parathënies së Simon Bllejk (Blake)

Kompakti Kombëtar duhet të ofrojë kornizë për të udhëhequr veprimet lokale në bazë të Kompaktit, duke siguruar marrëdhënie produktive në të gjitha nivelet.

Aktualisht, 100% e zonave lokale në Angli janë të përkushtuara drejt një partneriteti më të mirë, duke punuar mes qeverive lokale, organeve lokale publike dhe organizatave lokale vullnetare dhe të komunitetit përmes Kompakteve lokale.

Kompaktet lokale janë dokumente që evoluojnë, të cilat rregullisht përfshijnë dispozita të hollësishme për procedurën e konsultimit.

Si shembull, Kompakti lokal i Buckinghamshire përcakton si në vijim:

“Konsultimi Të dy sektorët pajtohen se konsultimi është proces dykahësh, i cili në shumë raste ndikohet nga qeveria. Të dy sektorët pajtohen të bëjnë si në vijim:

- Bashkërendimi, zhvillimi dhe përmirësimi i metodave ekzistuese të konsultimit për t’u siguruar që të gjithë të përfshihen në to;
- Vlerësimi i nismave të reja relevante, i dokumenteve të konsultimit, i politikave dhe procedurave, posaçërisht në fazën e zhvillimit të tyre, me qëllim të identifikimit të implikimeve për të dy sektorët;
- Njohja e rëndësisë së përfshirjes së përfaqësuesve të njëjtë në punët konsultuese dhe të partneritetit, dhe që këta përfaqësues të kenë autoritetin e duhur.

Një udhëzues i mirë i praktikave do të zhvillohet së bashku nga të dy sektorët me qëllim të përkrahjes së kësaj pune.



Figura 9: Angli, rast studimor

Afatet e konsultimit

Pasi që shumica e komisioneve të menaxhmentit në sektorin vullnetar do të takohen çdo dy deri në tre muaj, sektori statusor do të tentojë t'i zbatojë rekomandimet e qeverisë, ku parashihen 12 javë për konsultime. Megjithatë, të dy sektorët kuptojnë kufizimet kohore, dhe nëse janë të nevojshme afatet më të shkurtra, ata do të marrin parasysh metoda dhe qasje alternative për t'u siguruar që të bëhen konsultime të cilësisë së lartë dhe të efektshme.

Të dy sektorët do të tentojnë të bashkërendojnë kohën e konsultimeve dhe, aty ky është e duhur, do të ndajnë resurset për të mos pasur konsultime të tepërta.

Konsultimet e qeverisë

Të dy sektorët pajtohen të bëjnë si në vijim:

- Ta njoftojnë njeri-tjetrin për konsultimet e mundshme të ardhshme nga qeveria dhe agjencitë e tjera, sipas mundësisë;
- Të ndajnë pikëpamjet dhe të bashkërendojnë reagimet, në rastet kur do të ishte e udhës të jepej mendimi apo pikëpamja e 'Bakingemshajrit';
- Bashkëpunimi për ta inkurajuar qeverinë të jep njoftime sa më të hershme lidhur me oraret e konsultimit dhe afatet realiste.

Informatat për konsultim

Të dy sektorët pajtohen të bëjnë si në vijim:

- Të shpjegojnë se cila do të jetë tema e konsultimeve dhe pikëpamjet e kujt kërkohen;
- Të shpjegojnë arsyen pse kanë zgjedhur metodën e caktuar të konsultimit;
- Aty ku është e mundur, të ofrohet një përmbledhje e konsultimit, dhe të thuhet se ku mund të gjendet versioni i plotë i tij;
- Përdorimi i gjuhës së thjeshtë, pa ndonjë zhargon të panevojshëm apo, nëse kjo nuk është e mundur, duhet të shpjegohen termat e ngushta të specializuara;
- Të shpjegohet se si dhe kur do të shfrytëzohet informata e marrë gjatë konsultimeve;
- Të ofrohet informata për ata që kanë marrë pjesë në konsultime dhe rezultatet e tyre;
- Dhënia në dispozicion e dokumenteve të konsultimit në formate të ndryshme, aty ku është e mundur;
- Dhënia e përgjigjes së përbashkët, aty ku është e mundur.

Sektori statusor do të bëjë si në vijim:

- Të qartësohen situatat ku konsultimet mund të rezultojnë me ndryshime; - Të ceket se sa faza të konsultimeve do të zhvillohen dhe kush po konsultohet; - Të qartësohet se pse një grup i caktuar vullnetar apo i komunitetit po konsultohet për një çështje të caktuar (për shembull, si ofrues i shërbimeve, si përfaqësues i komunitetit apo i vullnetarëve, si përfaqësues i sektorit civil, si organizatë për mbajtjen e fushatave e kështu me radhë).

Sektori civil do të bëjë si në vijim:

- Ofron dhe publikon informata për konsultimet, në rastet kur kjo është e duhur;. - Do të shfrytëzojë rrjetet e saj të organizatave për të inkurajuar dhe përkrahur pjesëmarrjen e duhur në konsultime; - Do të qartësojë nëse përgjigjet si ofrues i shërbimeve, si përfaqësues i komunitetit apo i vullnetarëve, si shfrytëzues i shërbimit apo si organizatë për mbajtjen e fushatave; - Do të qartësojë nëse përgjigjet e tyre bazohen në konsultime me anëtarët apo në përvojën dhe njohuritë e tyre personale

Sektori statusor do të bëjë si në vijim:

- Të qartësohen situatat ku konsultimet mund të rezultojnë me ndryshime; - Të ceket se sa faza të konsultimeve do të zhvillohen dhe kush po konsultohet; - Të qartësohet se pse një grup i caktuar vullnetar apo i komunitetit po konsultohet për një çështje të caktuar (për shembull, si ofrues i shërbimeve, si përfaqësues i komunitetit apo i vullnetarëve, si përfaqësues i sektorit civil, si organizatë për mbajtjen e fushatave e kështu me radhë). Rishikimi i rregullt i marrëveshjeve lokale është i rëndësishëm për të vlerësuar suksesin e zbatimit të tyre.

Në rajonin Lindor, grupi i Kompaktit përdorë anketën e dizajnuar nga NCVO e cila u dërgohet njerëzve si në sektorin publik, ashtu edhe në atë civil. Grupi i Kompaktit vlerëson përgjigjet, përfaqëson rezultatet dhe i propozon veprime LSP-së.

Thënë në përgjithësi, Anglia tregon realizim të madh të partneritetit të vërtetë mes Qeverisë, pushtetit lokal dhe OShC-ve në kuptim që mekanizmat e tij kanë qenë të suksesshëm në zbatim, si rezultat i përkushtimit dhe dedikimit të të gjitha palëve.

Hungaria

Një nga shembujt e mirë për dekretin lokal është Dekreti për çështjet e marrëdhënieve mes Organizatave të shoqërisë civile dhe komunës së Budapestit dhe procedurat e tenderit, e miratuar nga Këshilli komunal i Budapestit.



Figura 10: Hungari, rast studimor

Dekreti siguron të drejtën e OShC-ve për të shprehur mendimin e tyre, si dhe paraqet rregullat e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes. Disa nga format specifike të bashkëpunimit të theksuara në Dekret janë:

- i) organizatat civile ftohen në takimet e Kuvendit komunal;
- ii) OShC-të mund të komentojnë në këto projektligje, të cilat prekin qytetarët dhe mbulojnë pyetjet konceptuale;
- iii) organet konsultative themelohen për çështje specifike, me përfshirjen e OShC-ve;
- iv) mbajtja e forumeve civile me qëllim të informimit dhe konsultimeve;
- v) krijimi i bordit profesional këshillëdhënës dhe konsultativ

Një nga modelet e bashkëpunimit dhe partneritetit, i paraqitur në shtojcën e dekretit quhet Bordet e konsultimit apo punëtoritë civile.

Rregullat kornizë për punën e bordeve konsultative (të ashtuquajturat punëtori civil).

Qëllimi i punës së organeve civile

- 1) Këshilli civil konsultativ dhe punëtoritë qytetare sektoriale-profesionale (më tutje në tekst: organet civile) janë forume institucionale për lidhje mes komunës dhe sektorit të

- vetorganizuar publik në Budapest, në bazë të parimeve demokratike të pjesëmarrjes së qytetarëve, partneritetit dhe publicitetit.
- 2) Organet civile sigurojnë kornizë të organizuar për pjesëmarrje në çështje publike për komunitete dhe qytetarë dhe marrin parasysh mendimin e tyre në marrjen e vendimeve në komunën e Budapestit
Procedura e themelimit të sistemit të organeve civile
 - 3) Përmes themelimit të sistemit të organeve civile, zyra e kryetarit të komunës i dërgon ftesë komuniteteve të vetorganizuara të Budapestit dhe një formular aplikimi për të themeluar punëtoritë profesionale civile, të cilat merren me popullatën e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, përdoruesit e drogës, të pastrehët, çështjet sociale dhe të kujdesit shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qytetit, punët e qytetit, si dhe me çështjet arsimore, kulturore dhe të sportit.
 - 4) Organizatat civile parashtrojnë aplikacionin e tyre brenda afatit të caktuar, duke cekur punëtorinë profesionale, ku dëshirojnë të marrin pjesë, si dhe duke caktuar personin, i cili përfaqëson organizatën në bazë të vendimit të bordit të saj.
 - 5) Në bazë të aplikacioneve të parashtruara, zyra e kryetarit të komunës zbaton procedurën e akreditimit në bazë të si në vijim: - Organizata civile aplikuese është e regjistruar në gjykatë dhe është entitet juridik; - Forma juridike e organizatës civile është asociacion (aleancë) ose fondacion
- Organizata civile funksionon kryesisht në Budapest për interesa të popullatës së qytetit; - Ato organizata civile, të cilat janë themeluar që ta përkrahin aktivitetin dhe punën e institucioneve të pushtetit lokal mund të bëhen anëtare të sistemit vetëm në rast se përveç përkrahjes së institucioneve u ofrojnë edhe shërbime qytetarëve;
- 6) Mundësia për parashtrimin e dokumenteve që mungojnë u jepet aplikuesve gjatë procedurës së akreditimit. Aplikacioni refuzohet në rast se aplikuesi nuk i korrigjon mangësitë brenda afatit të caktuar kohor. Megjithatë, kjo nuk përjashton mundësinë e riaplikimit nëse respektohen kërkesat për akreditim. Aplikacioni për punëtori është i vazhdueshëm dhe i hapur.
 - 7) Punëtoritë profesionale në fjalë mund të themelohet në rast që së paku pesë organizata aplikojnë të marrin pjesë në punën e saj. Punëtoritë profesionale pushon së ekzistuari në rast se numri i organizatave që de fakto marrin pjesë në punën e saj zvogëlohet në më pak se 5;
 - 8) Takimi i parë i punëtorisë profesionale thirret nga zyra e kryetarit të komunës. Në këtë takim informohet komisioni që ka juridiksion profesional për çështjet në fjalë lidhur me themelimin e punëtorisë. Zyra e kryetarit të komunës publikon listën e atyre organizatave civile, që kanë të drejtë pjesëmarrje në punëtoritë profesionale.
 - 9) Në takimin e saj të parë punëtoritë profesionale harton rregullat e veta të punës në përputhje me rregulloret e dekretit, dhe zgjedh nga radhët e anëtarëve të saj kryetarin me mandat njëvjeçar;
 - 10) Kryetarët e punëtorive profesionale formojnë Këshillin civil për konsultim. Takimi i parë i Këshillit thirret nga zyra e kryetarit të komunës. Në takimin e tij të parë, këshilli harton rregullat e veta të punës në përputhje me rregulloret e dekretit, dhe zgjedh nga radhët e anëtarëve të saj kryetarin me mandat njëvjeçar. Bashkëkryetari i këshillit është personi i emëruar nga Kuvendi i përgjithshëm metropolitan dhe është përgjegjës për marrëdhëniet civile.
 - 11) Pas zhvillimit të sistemit të organeve civile, Këshilli për konsultime civile vendosë të krijojë punëtori të tjera profesionale apo të përfundojë punën e tyre a t'i bashkojë ato.

Para vendimit të tij, Këshilli për konsultime civile negocion me komisionet relevante të Kuvendit të Përgjithshëm.

E drejta dhe kompetenca e organeve civile

- 12) Punëtoritë sektoriale profesionale mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me dokumentet e ofruara nga kuvendi i përgjithshëm dhe nga komisionet e kuvendit të përgjithshëm;
- 13) Këshilli për konsultime civile shpreh mendimin e vet lidhur me çështjet konceptuale për marrëdhëniet e pushtetit lokal me qytetarë dhe me çështjet e tjera, të cilat nuk i përkasin specializimit të ndonjë punëtorie;
- 14) Punëtoritë sektoriale profesionale mund t'i bëjnë sugjerime komisionit përkatës të kuvendit të përgjithshëm për të diskutuar çështje apo propozime specifike;
- 15) Sistemi i organeve civile – në bazë të bashkëpunimit me çdo komision – përmbledh përvojat lidhur me statusin, punët, mundësitë zhvillimore të partneritetit civil me pushtet lokal.

Për më tepër, përgatitë vlerësimin përmbledhës për Kuvendin e Përgjithshëm Metropolitan, i cili parashtrohet nga personi i emëruar nga Kuvendi i Përgjithshëm Metropolitan dhe përgjegjës për marrëdhëniet civile.”

Kroacia

Kushtetuta e Kroacisë është një nga kushtetutat shumë të pakta që shprehimisht parasheh të drejtën e pjesëmarrjes lokale. Sipas nenit 133: “qytetarët mund të marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në administrimin e çështjeve lokale përmes takimeve, referendumeve dhe mënyrave të tjera të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë në pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloret lokale.”

Një numër në rritje e sipër i qeverive lokale është duke miratuar karta lokale të bashkëpunimit mes OShC-ve dhe qeverive lokale (p.sh., Rijeka, Shibeniku, Sisaku, Zhupanja, Beli Manastiri).

Si shembull, në vitin 2008 Kuvendi i qytetit të Sisakut gjithashtu miratoi një Kartë për bashkëpunim të qytetit të Sisakut dhe shoqatave ku është shprehur një gatishmëri dhe dëshirë për të zhvilluar partneritet të barabartë me shoqatat e qytetarëve. Përveç Kartës për bashkëpunim, qyteti i Sisakut gjithashtu miratoi dokumente shtesë që përmbajnë dispozita për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile siç janë nevojat e programeve publike dhe veprimeve komunale për të rinjtë.



Figura 11: Kroaci, rast studimor

Karta është zhvilluar në bashkëpunim me shoqatat nga qyteti dhe secila shoqatë mund t'i bashkohet Kartës kurdoherë.

Qyteti bashkëpunon në mënyrë aktive me organizatat për zbatimin e projekteve.

Menyrat e bashkëpunimit.

Qyteti i Sisakut do të zhvillojë partneritete me shoqatat e qytetarët përmes mënyrave të bashkëpunimit të paraqitura si në vijim: këshillimit, informimit, financimit. Konsultimet do të mbahen përmes:

- Zhvillimit të mekanizmave efektivë që do të mundësojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, organizatave qytetare dhe iniciativave joformale të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe për përmbushjen e nevojave të komunitetit;
- Marrjes parasysh të propozimeve dhe sugjerimeve nga shoqatat e qytetarëve për përgatitjen e strategjive dhe programeve zhvillimore, si dhe prioritetizimin e nevojave të qytetarëve;
- Përfshirjes së përfaqësuesve të organizatave qytetare në organet punuese për të përgatitur dhe shqyrtuar propozime për zhvillime domethënëse të komunitetit dhe shoqërisë civile;
- Informimi arrihet përmes:
- Fuqizimit të dialogut dhe të komunikimit të dyanshëm mes qeverisë së qytetit dhe qytetarëve;
- Shkëmbimit të informatave që janë të rëndësishme për zhvillimin e komuniteteve lokale dhe shoqërisë civile;

Ngritjes së sistemeve informative dhe sistemeve të ndërlidhura që mundësojnë dhe lehtësojnë realizimin e të drejtave të qytetarëve për qasje në informata;

- Azhornimit të lidhjeve të shoqatave qytetare në faqen e internetit të qytetit të Sisakut.

Mali i Zi



Figura 12: Malit i Zi, rast studimor

Si iniciativë e ndërmarrë kohëve të fundit, më 15 prill 2010, Qeveria e Malit të Zi miratoi një vendim për themelimin e Këshillit për bashkëpunim mes qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile, i cili është organ i ngjashëm me Këshillin për zhvillimin e shoqërisë civile në Kroaci.

Këshilli vepron si organ këshillëdhënës i qeverisë; synimet e tij kryesore janë zhvillimi i mëtejshëm i mekanizmave institucionale të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së OJQ-ve, monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe përmirësimi i marrëdhënieve mes qeverisë dhe OJQ-ve. Këshilli përbëhet prej kryesuesit dhe 24 anëtarëve prej të cilëve 11 janë përfaqësues të ministrive dhe shefi i zyrës për bashkëpunim me OJQ dhe 12 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë civile. Përfaqësuesit e shoqërisë civile zgjidhen përmes konkurseve publike. Këshilli mbledhet një herë në muaj, dhe anëtarët nuk paguhet për punën që kryejnë në këtë këshill.

Rasti studimor i Perth- it, Australia Perëndimore

Në Shtator të vitit 2013, 1,100 njerëz morën pjesë në procesin konsultues për planifikimin e së ardhmes për zonën metropolitane të Perth-it, kryeqytet i Australisë Perëndimore, me qëllimin e “zhvillimit të Perth-it deri në vitin 2030 si qyteti më i jetueshëm në botë”.

Duke qenë se procesi i pjesëmarrjes në planifikim karakterizohet nga aspekte pozitive dhe jo pozitive, planifikuesit duhet të marrin vendimin nëse do ta ndërmarrin procesin apo jo, dhe nëse po, atëherë si do ta ndërmarrin procesin e dialogut.

Industria, media dhe entitetet jo-qeveritare ishin partnerë me Qeverinë Shtetërore dhe mbështetën pjesëmarrjen e qytetarëve.

Pjesëmarrja përgjatë këtij procesi kishte si synim përfshirjen e përfaqësuesve sa më të ndryshëm të shoqërisë civile, biznesit dhe sektorëve qeveritarë për të inkurajuar dialogun mes këtyre grupeve, që është i nevojshëm për planifikim të qëndrueshëm.

U inkurajua vizionimi afatgjatë që tejkalonte çështjet dhe problematikat momentale. Pjesëmarrësve iu kërkua që të mendonin për planifikimin e Perth- it pas tridhjetë vjetësh, që i bëri ata të mendojnë për jetën e fëmijëve dhe nipërve të tyre dhe për vitet e pensionit të tyre.

Forumi publik i cili u emërtua “Dialog me qytetin” përfshiu tema diskutimi, pyetësorë me 1,700 banorë, diskutime online në faqe interneti, një konkurs shkollor, forum një ditor me 1,100 pjesëmarrës dhe seminare të vazhdueshme, sigurojnë një platformë mbi të cilën qytetarët, qeveria dhe biznesi mund të ndërtojnë diskutime mbi vizionin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të Perth- it. Ky dialog shërbeu për të rikonfirmuar faktin se banorët e Perth-it



Figura 13: Australi, rast studimor

3.5 Pjesëmarrja e komunitetit ne projekte infrastrukturore **Rast studimor, Tirane**

Analizimi i këtij rasti studimor është të theksoj rëndësinë e pjesëmarrjes së komunitetit ne zhvillimin e Infrastrukturave Peri - Urbane të qytetit të Tiranës. "Përfshirja e komunitetit" nenkupton se i ke dhene komunitetit një zë në formësimin e mjedisit të tyre të ardhshme për të promovuar rigjenerimin urban në kombinim me respektimin e parimit të qëndrueshmërisë. Kjo tablo e pasur e pjesëmarrjes së komunitetit ne planifikimi urban, është nje iniciative e Komisionit te Bashkimit Evropian ne Shqiperi.

Qëllimi i projektit:

Qëllimi i projektit merr persiper te depertoje dhe te faktoje Pjesëmarrjen e komunitetit, ne projekte te vogla infrastrukturore po me nje ndikim te madh ne rigjenerimin e hapësirave

publike. Ndryshe mund të ilustrohet se si projektet e rigjenerimit urban mund të kenë një ndikim të madh në të gjithë jetën e qytetit.

Rezultati është për të krijuar një ambient që përmirëson stilin e mirë të jetës; ri-konceptimin e investimeve, investime keto që edhe pse me një kosto relativisht të ulët mund të ketë një ndikim të madh.

Ky studim thekson nevojën për një metamorfozë të vërtetë, ndaj të gjitha barrierave që ekzistojnë mes Ndërtuesit dhe Përdoruesit, që duhet të eliminohen, kështu që Ndërtimi dhe Përdorimi të jenë dy pjesë të ndryshme, brenda të njëjtit proces planifikimi.

Ne Shqipëri ende nuk ka politika të qarta dhe direktiva të zhvilluara të cilat mund të orientojnë sektorin publik dhe partnerë të tjerë drejt formimit të bashkepunimeve efektive. Ky është një tregues që e ka bërë pjesëmarrjen e komunitetit të jete i kufizuar dhe teper i vakët. Në thelb është nevoja që njerëzit të besojnë se politikanet janë të zgjedhur nga komuniteti për t'i përfaqësuar ata, duke adresuar kështu shqetësimet e tyre dhe interesat më të mira në përmirësimin e mirëqenies dhe "cilësisë së jetesës" së komunitetit.

“Te ndertojmë së bashku” është përshkruar si një vision, një planifikim strategjik dhe demokratik i cili synon veprimet se çfarë bën një komunitet, si e bën, dhe pse e bën atë. Sot pjesëmarrja e Komunitetit në planifikim është sinonim me protestat, nuk ndodh asnjëherë në të njëjtin moment me vendimmarrjen, por vjen gjithnjë me pas, si një reagim ndaj saj. Eksperiencat tregojnë se filozofia e “Planifikimit me Pjesëmarrje” është pothuajse e njëjta si në zonat formale ashtu edhe në ato informale. Njerëzit në zonat jo periferike (të qendres) janë më të terhequr, kjo pasi ata shpesh janë të zhgënjyer nga neglizhencat e Autoriteteve.

Disa komunitete janë homogjene ndërsa të tjerët janë heterogjene; dhe disa të bashkuar ndërsa të tjerët të ndara. Disa komunitete udhëhiqen nga liderët e zgjedhur në mënyrë demokratike, të cilët veprojnë relativisht të pavarur, disa të tjerë vete udhëhiqen, të tjerë të qeverisur nga lider i imponuar.

Disa komunitete perceptohen në Komuniteti në bazë të vendndodhjes gjeografike, disa të tjerë janë Komunitet etnike, racor, dhe fetar, në të cilën anëtarësimi është i bazuar në etnikë racat, ose identifikimi fetar, e në grupin e trete përfshihen Komunitetet bazuar në familje të mëdha, që jetojnë së bashku. Nga përvojat dhe qasjet e pjesëmarrjes në vendet të tjera, deshmohet se prejardhja sociale-kulturore dhe historike e një vendi, ndikon në mënyrën se si njerëzit i perceptojnë apo interpretojnë ato.

Në Mbretërinë e Bashkuar (U.K) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USA), për shembull, debati ka qenë i fokusuar në “Pjesëmarrjen për sa i përket zgjedhjes” p.sh. shkolla dhe qeverisja e shkollës, ndërsa në vendet në zhvillim qendrën e debatit në komunitet e paraprin p.sh. ndërtimi i shkollave, përmirësimi i jetesës së femijëve, standartet dhe menaxhimin.

Në këtë rast studimor shqyrtohet pjesëmarrja e komunitetit, (në bazë të vendndodhjes gjeografike), nëpërmjet “Konsultimeve Publike” për ndërtimin e infrastrukturave sociale.

Objektivat e kerkimit:

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është që të shqyrtojë “Rëndësine e pjesëmarrjes së komunitetit ne procesin e vendim marrjes, duke kontribuar sadopak ne konceptin, vizionin dhe para caktimin e termave te references”

Objektivat specifike janë si më poshtë:

- Vlerësimi i rolit te Komunitetit Pjesëmarres gjatë fazes se projektimit dhe ndërtimit te godinave infrastrukturore.

Qasjet e Komunitetit Pjesëmarres

Kur njerëzit perfshihen në projektim, ne konceptimin dhe mirëmbajtjen e vendit ku ata banojne, ata zhvillojnë një interes te madh ndaj këtyre hapësirave. Kur banoret pajisen me një ndjenjë te "pronësisë" ambienti perqark bëhet një vend më i mirë për të jetuar, punuar dhe për të vizituar.

"Sa më shpejt te përfshihet komuniteti në procesin e planifikimit, aq me ideal eshte planifikimi" Kathy Madden dhe Fred Kent theksojne në librin "How to turn a place around"

Minneapolis, Minnesota: Peavey Park, Hope Community

“Komuniteti i shpreses ne Minneapolis” simulimi i vete-imazhit te komunitetit te tyre.

Komuniteti i shpreses ne Minneapolis, nuk e ka bërë vetëm qe njerëzit te besojnë qe gjërat e mëdha janë të mundshme, por ajo tashmë ka arritur deri ne realizimin e tyre. Nepermjet nje “assetbased” u arrit strategjia e “procesit degjimor”, ne te cilin “ Komuniteti i shpreses” solli njerez te etnive te ndryshme se bashku, ne dialogje grupesh te vogla.

“Komuniteti i shpreses” organizoi tri projekte te medha degjimi, per hartimin e parkut, secili perfshinte mbi 300 anetare te rrinj, me arsim te ndryshem, dhe profesione te ndryshme. Lagjja Philips, ne jug te qendres se qytetit, eshte nje nder lagjet me te varfra te tetedhjete lagjeve te Mineapolis- it. Ne vitin 1997, “ Komuniteti i shpreses” nisi projektin e “degjesave publike” per te ndihmuar dhe per te mesuar ne lidhje me idete e banoreve ne arsim dhe punesim. Keto diskutime cuan ne ridisenjimin e Peavy Park, nje park totalisht i degraduar, shpesh here edhe pjese ne krime te ndryshme. Planifikimi i ketij parku ishte nen autoritetin e Bordit te Parqeve te Minneapolis.

Degjimi dhe vizionimi i procesit, detyruan komunitetin per tu angazhuar ne pjesemarrje te gjere e per te theksuar fort se Ndertesa e Komunitetit ishte qellimi kryesor ne parkun e Minneapolisit. Projekti nisi vetem pasi ishin kryer nje seri konsultimesh, seminaresh , debatesh e diskutimesh, te cilat me vone u pershtaten u moren ne konsiderate nga Bordi i Parqeve te Minneapolis. Ne perfundim kjo qender e mire projektuar per aktivitetin e komunitetit do te sinjalizonte nje kthese massive per nje lagje e cila ishte e infektuar gjate nga droga, varferia dhe mungesa e shpreses.

Republika Ceke, Brno

Shume qytete perballen me sfiden e konvertimit te nje prone te vlefshme industriale, me vlera historike, e cila nuk eshte perdorur per nje kohe te gjate dhe ka humbur qellimin e saj original

dhe perfaqeson nje mundesi per te sjelle perdorues te rinj. Keto fabrika kane hapesira fleksibel, seri sallash industriale mbreselenese, me hapesira papafingo, me potenciale te medha perdorimi per lloje te ndryshme aktivitetesh, pavaresisht nga shkalla e ketyre hapsirave.

Nje rast i tille eshte edhe Fabrika Vankovka, ne Brno, Republika Ceke, e vendosur ne afersi te qendres historike te qytetit, e cila u shpetua nga rrenimi dhe u percaktua si nje pike referimi historike.

Nje OJQ u angazhua me promovimin e vizionit te bazuar ne idete e komunitetit per godinen ne fjale. Ajo sponsorizoi qindra evente ne kete hapesire, duke bere permiresime te perkoheshme per hapsira te perdoreshme.

Bazuar ne mbeshtetjen e komunitetit, qyteti bleu kompleksin e fabrikes Vankovka. Fabrika tashme eshte shnderruar ne nje qender tregtare me dyqane, kafene, restorante dhe ambjente polifunksionale – nje destinacion i vertete per qytetin e Brno, te Republikes Ceke.



Figura 14: Republika Ceke, Brno, rast studimor

Promovimi i barazisë përmes Komunitetit Pjesëmarres

Duke punuar me komunitetin lokal në Allias, e cila është një nga lagjet me të izoluarat të Tiranës, cuditerisht vihet re se banorët e këtij komuniteti, janë ndër më të organizuarit në qytet. Ato janë veçanërisht aktive në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në sajë të mbështetjes së EU Delegacion in Albania, janë identifikuar nevojat arsimore dhe nevojat e permisimit të infrastructures të kësaj zone periferike të Tiranës.

Nga ana tjetër një rol të rëndësishëm luajti edhe Bashkia e Tiranës, e cila doli me plane konkrete për të bashkëpunuar për përmirësimin dhe integrimin e komunitetit.

Ne analizen e situatës u përfshinë të dhëna dhe informacione nga stafi i njesise administrative 4,8, Tirane. Nje pyetesor perpara nisjes se hartimit te projektit u realizua me banore te komunitetin. Banoret e intervistuar, u pyeten drejtëpersëdrejt, rreth mendimeve të tyre për gjendjen ekzistuese të infrastuktures që i rrethonte, për mangësitë dhe problematikat në komunitet.

Analiza e situates, propozimi:

Komuniteti lokal në zonën Peri-urbane të Tiranës, Allias, është një nga lagjet më të izoluarat e Tiranës, përballur me sfidën e konvertimit të një pronë industriale që nuk është përdorur për qëllimin e saj origjinal dhe përfaqëson një mundësi për ta shndërruar në një zonë arsimore sociale dhe rekreative.

Fale mbështetjes së Delegacionit të BE në Shqipëri, dhe bashkëpunimit të Tiranës u identifikuan nevojat dhe prioritetet e komunitetit të asaj zone, për përmirësimin e sistemit i cili transformohet në një pengesë serioze për integrimin e atij komuniteti.

Projekti kishte për qëllim jo vetëm për të ndarë vizionin e komunitetit për ndërtimet e infrastruktures arsimore dhe sociale, por gjithashtu edhe për të provokuar Banorët / autoritetet lokale dhe për të ndryshuar sjelljen e tyre ndaj promovimeve konkrete në dobi të komuniteteve bazuar në aksione si : përmirësimi i hapsirave të gjelbërta, shesheve rekreative në bllokun dhe në lagjen e banimit.

Objektivat e projektit ishin:

- Promovimi në nivel lokal, duke rritur ndergjegjësimin si një nga menyrat për angazhimin qytetar dhe përfitimet e saj për të gjithë shoqërinë.
- Nxjitja e qytetarëve aktive. Njohje me standartet, normat dhe kushtet Evropiane të ndërtimit.
- Mbledhja dhe promovimi i shembujve dhe praktikave me të mira në bashkëpunimin midis organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve, që reflektojnë vlerat evropiane, demokratike, mbizotërimin e ligjit dhe të hapjes ndaj përdorimit të teknologjive të reja të informacionit dhe të komunikimit si mjete për të mundësuar nxitjen e pjesëmarrjes qytetare.
- Të vlerësojë rolin e pjesëmarrjes së komunitetit gjatë “degësave publike” si dhe të vlerësojë organizimin e dialogjeve në grupe të vogla për procesin e projektimit.

“iC consulenti studio”, përgatiti propozimin dhe përpunoi me detaje raportin e situatës aktuale në pjesën 4, 8 (winning studio from Vienna worked closely during the project with local winning with iC consulenti Albania, EUROPEAN COMMISSION. C(2012) 8208 final, 09.11.2012) . Me rëndësi vlen të theksohet bashkëpunimi midis një kompanie të huaj me eksperiencë ndërkombëtare dhe përmbushja e nevojave dhe dëshirave të banorëve të këtyre 2 pjesëve. Raporti ve theksin në kërkesën e komunitetit, për mungesën e një qendre komunitare- sociale, si dhe mungesën e hapsirave publike dhe rekreative për ta dhe femijet e tyre.




Figura 15: Pozicionimi i njësive administrative n. 4 and 8, Tirana

Projekti është hartuar për të marrë reagime të vazhdueshme nga palët e interesuara në këtë proces. Në zonat administrative, është zhvilluar një seri dëgjimesh dhe konsultash publike nga qytetarët, arkitektët, inxhinierët dhe planifikuesit MT-së (Bashkia e Tiranës). Ajo që vlen të përmendet është vlerësimi i disa propozimeve dhe sugjerimeve të aktorëve të ndryshëm të cilët e kanë pasuruar projektin dhe kanë kontribuar për rafinimin dhe zbatimin e idesë në projektin e detajuar.

Projekti i përgatitur nga konsulenti ka të bëjë me:

"Ndërtimi i e 3 godinave, të cilat bëjnë pjesë në infrastrukturen sociale për komunitetet lokale në Tiranë. Projekti i studimit të pjesshëm urban konsiston në ndërtimin e një Shkolle 9 vjecare, e cila zhvillohet në tre kate, Cerdhe/ Kopesht dy kate dhe ndërtimi i një Qendre Sociale, dy kat – (e cila erdhi si shtesë në projektin fillestar), të gjitha të vendosura në një kompleks, në periferi të qytetit të Tiranës.

Zona e propozuar nga Bashkia e Tiranës

(Njësitë administrative 4, 8) qëndron në vijën periferike të qytetit në kufi me komunën e Paskuqanit. Gjatë sistemit socialist zona ishte përdorur si territor industrial. Nga fillimet e viteve '90, zona u pushtua në mënyrë të paligjshme dhe u zaptua nga ndërtimet informale të banorëve që emigruan nga pjesë të ndryshme të vendit.

Popullsia përbëhet nga rreth 16.000 banorë. Në këtë zonë aktualisht vihet re mungesa e shërbimeve sociale dhe infrastruktura e rregullt, duke përfshirë edhe tubacionet e ujit, rrjetit të kanalizimit, rrugët e brendshme, trotualet etj. Por jo vetëm kaq, mungesa e ndetimeve arsimore për të shërbyer komunitetin, (sidomos fëmijëve) është tepër e evidente në këtë zonë.

Për këtë arsye ndërtimi i objekteve arsimore dhe infrastruktura sociale për komunitetin lokal u përfshi në projektet e EU-IPA 2012, programi për Shqipërinë, për të siguruar infrastrukturën arsimore dhe publike në nevojë të komunitetit periferik të Tiranës.

Në Tiranë rreth 16,000 banorë do të përfitojnë nga ndërhyrjet përfshira në kete projekt.

- Shkolla 9 vjecare me siperfaqe 4595 sqm,
- Cerdhe / kopsht me siperfaqe 1,703 m² dhe
- Qendër Sociale me siperfaqe 1,961 m².
- Projekti IPA 2012 i financuar nga Bashkimi Evropian, Delegacioni në Shqipëri, me nje vlere prej rreth 2,151,159.17 euro.

Në këtë kontekst, Delegacioni i BE-së në Shqipëri, së bashku me Konsulentin i dhanë mbështetje të plotë "Interesit komunitar" përmes aktiviteteve të informimit dhe konsultimeve publike.

Qe ne momentin kur u has me procesin e privatizimit, njerezit nuk i kushtuan me vemendje hapsirave publike per mbledhjen e grupeve kolektive, e sidomos nese i referohemi zonave periferike te qyteteve kryesore. Nje boshlllek dhe disbalance e madhe u krijua midis situates se brendeshme (brenda banesave) dhe jashte tyre (oborret, lagjet, bllokun).

Ata përgatitën një proces të gjithëpërfshirjes se komunitetit ne hartimin e termave te referencesë, përmes zhvillimit te nje serie të dëgjimeve publike me qytetarë, takime joformale mes grupeve të ndryshme etnike; arkitektët, inxhinierët dhe planifikuesit urban te bashkise se Tiranes; zhvillimi i diskutimit ne tryeza të rrumbullakëta, përhapjen e informacionit në media nga komisionet këshillimore dhe organet koordinuese etj.

Në këtë drejtim u arrit në përfundimin se rritja e pjesëmarrjes se komunitetit rriti edhe efektivitetin e projektit, veçanërisht në zonen peri – urbane , te marre ne shqyrtim.

Pjesëmarrja i lejoi këta njerëz të kenë një zë në përcaktimin e objektivave te projektit ne fjale. Një proces i tillë konsultativ ndihmon se tepermi ne marrjen e vendimeve te duhura. Profesionistët, akademikët , inxhinjerët, arkitektët janë të detyruar për të marrë ne konsiderate pikpamjet e banoreve. Pjesëmarrja, pra lejon përdorimin me efikasitet të burimeve në dispozicion të një projektit.




Figura 16: Studim pjesor urban, plani i pergjithshem, rast studimor, Tirane



Figura 17: Pamje nga sheshi i ndertimi dhe rruget ne projektin infrastrukturor, Tirana

Mbledhja e te dhenave ishte si ne vijim:

- Analize rreth karakteristikave te pergjithshme te komunitetit si:
- Popullsia dhe tendencat e zhvillimit dhe levizjet e saj; struktura e popullise;
- te dhena rreth punesimit; mundesite e burimeve njerezore, etj.
- Analize per infrastruktura egzistuese si qendra sociale, shendetesore, arsimore; aktivite arsimore.
- Analize e zonave me rrezikshmeri ambjentale, te fokusuara kryesisht ne marrdhenien midis burimeve natyrale dhe kapitaleve sociale.
- Sherbimet infrastrukturore si: furnizimi me uje dhe energji elektrike, grumbullimi dhe mbledhja e mbetjeve te ngurta, rrjetet rrugore dhe mirembajtja, kanalizimet dhe telekomunikacioni, sherbimi i transportit publik etj.

Konkludime:

Pas nje sere konsultimesh midis komunitetit pjesemarres, u percaktuan keto kritere, per permisimin e projektit:

- Insistimi i komunitetit ne krijimin e nje Qendre komunitare- sociale, 2 fusha tenisi basketbolli dhe futbollit;
- Vendorsja e nje ekrani te madh per shfaqjen e eventeve, filmave etj
- Lidhja e tre godinave me njera tjetren.
- Akset e levizjes se kembesoreve ne rruget qe te cojne ne godinen e shkolles dhe kopeshtit duhen permiresuar, ne kontekstin e rrugeve te kalimit te makinave. Ato duhet te jene ne seksione te ndara, te vecuara (kembesore-makina), per te ulur keshtu rrezikun ndaj makinave.

Ne kete kontekst rreziku ose disavantazhi i pjesemarrjes se komunitetit ne kete iniciative, qendron vetem nese mendimi i tij injorohet, dhe nuk merret ne konsiderate.

Përfundime:

Në përfundim, autoriteteve publike (si bashkia, njesi administrative, dhe ente te ndryshme) u keshillohet të ndjekin keto nisma pozitive te hartuara nga Delegacioni i Bashkimit Evropian ne Shqiperi, "në lidhje me pjesëmarrjen e komunitetit" ne hartimin dhe vendim marje ne procese urbane.

Ky model vizionar mund të ndihmojnë dhe të inkurajojë Pjesëmarrjen e komunitetit ne vendim marje dhe te shërbeje si një model për proceset bashkëpunuese ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

Problemi i pjesëmarrjes në Shqipëri është edhe më i madh nëse kemi parasysh faktin se shpesh projektet zhvillimore ose studime të pjesshme urbane fillojne nga faza e zbatimit të projektit, pa miratimin e lejeve te ndërtimit nga autoritetet perkatese dhe per me teper me nje mungese totale te informimit publik ose zhvillimit te konsultave publike.

Komunikimi i mirë mes pushtetit lokal dhe qytetarit është çelësi për te arritur standartet e duhura, te kultures demokratike te pjesemarrjes. Është e rëndësishme për të nxitur një klimë bashkëpunimi midis komunitetit dhe partnereve te tjere ne studime urbane, projekte zhvillimor, qofshin keto private ose publike.

Pjesemarrja e publikut eshte nje element kyc per demokracine e nje vendi. Shqiperia i eshte nenshtuar ndryshimeve te medha ne lidhje me perfshirjen e qytetareve ne hartim politikash, vendimmarrje, procese ne lidhje me ligjin dhe formesimin e sistemit te saj demokratik.

Megjithate , mbetet ende sfide:

- a. Informacioni i paket;
- b. Kuptimi qe qytetaret kane per te drejtat dhe pergjegjesite e tyre;
- c. Pjesemarrja e ulet e qytetareve ne proceset vendimmarrese dhe ne hartimin, zbatimin dhe monitotimin e ligjeve
- d. Zbatimi ne menyre korrekte i kornizes ligjore nga zyrtaret publike



Pamje nga interieri, Projekti infrastrukturor



Kopesht, cerdhe , Projekti infrastrukturor



Qendra Komunitare, Projekti infrastrukturor



Sisteme te jashtme, Projekti infrastrukturor

Figura 18: Pamje nga zbatimi i Projektit infrastrukturor, rast studimor

KAPITULLI 4

4 Korniza aktuale ligjore mbi Pjesëmarrjen

.....e ndersa te gjitha periferite e qyteteve kryesore po rrethoheshin nga ndertime qe fillimisht askush nuk i besoi se po ndodhnin dhe nuk i kuptoi se nga se dhe perse vinin, qendrimi zyrtar i te gjitha institucioneve ligjore ishte moskonsiderimi dhe berja sikur fenomeni te mos ekzistonte.

Kjo ndodhi pasi institucionet nuk ishin ne gjendje te ofronin asnje zgjidhje. Ne fakt kjo dukuri thjesht po lihej pas dore pasi nuk permblidhej brenda kornizës legjislative te institucioneve kryesore administruese dhe akademike. Vetem pas viteve 90-te filloi nje epoke e re per bashkëpunimin ne planifikim, te cilit pervec se i duhej te gjente zgjidhje per problemin dhe fenomene te cilat ishin te panjohura deri atehere, i duhej edhe “te luftonte” brenda vetes per te rishikuar kompetencat dhe edukimin profesional te burimeve njerëzore te fushes.

Projektet e realizuara nga qeveria apo bashki te ndryshme ne dy dekadat e fundit ne Shqipëri, kane hasur problematika ne lidhje me pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin midis aktoreve te përfshire. Pjesëmarrja eshte bazuar ne marrëdhënie vullnetare midis aktoreve, te cilet perfshinin institucione qeverisese, individe, organizata jo qeveritare, grupe ne komunitet etj.

Mungojne politikat e qarta dhe udhezimet perkatese te cilat mund te udhehiqnin institucionet publike ne procesin e nje partneriteti eficient në raport me aktoret e tjere pjesëmarrës ne projekt.

Ky eshte nje tregues i cili e ka bere pjesëmarrjen e komunitetit dhe kontributin e tyre të kufizuar. Në thelb te zhvillimeve demokratike ne Shqipëri, qendron nevoja qe njerezit apo komuniteti të besojne ne politikat dhe ligjet perfaqësuese, duke adresuar keshtu shqetësimet dhe përmisimin e cilesisë së jetesës.

Si vend kandidat potencial, Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet në përafrimin e legjislacionit dhe zbatimin e standardeve evropiane (BE), ndërkohë që respektimi dhe zbatimi në terren duhet të përshpejtohet nëpërmjet ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve të agjencive dhe institucioneve.

Komisioni Evropian për vitin 2007-2009 theksonte që Agjencia e Prokurimit Publik vazhdon të jetë e dobët. Progresi në këtë fushë është jetik për përmirësimin e qeverisjes së sektorit publik, një prioritet kyç i Partneritetit Evropian, dhe për përmbushjen e detyrimeve në kuadrin e MSA-së. Për këtë arsye, Komisioni theksonte detyrën që nëpërmjet programeve që do të zbatoheshin të arrihej forcimi i kapaciteteve për Agjensinë e Prokurimeve Publike me synim zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit që është në përputhje me *acquis*. Marrëveshjen e Ndërmjetme, e cila tashmë është pjesë integrale e MSA-së. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, si një arritje e rëndësishme në kuadër të integritimit në BE, parashikon krijimin e një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së në një periudhë kohore 10-vjeçare.

Kjo marrëveshje solli liberalizimin e marrëdhënieve të tregtisë ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë sa i përket barrierave tarifore, si për produktet bujqësore ashtu dhe për ato industriale. Ajo stabilizoi bazat e sigurisë ekonomike dhe ligjore të lëvizjes së lirë të të gjithë llojeve të kapitalit në Shqipëri: nga jashtë-brenda dhe nga brenda-jashtë.

Thelbi i kësaj marrëveshjeje qëndron në atë që —Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me dëshirën e Komunitetit.

Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet. Së fundmi, Komisioni Evropian, në Progres Raportin 2011 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin në Tetor 2011 nënvizoi problematikat kryesore aktuale dhe të perspektivës për Shqipërinë me qëllim që të realizojë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, ndër të cilat përmendim:

Nevojiten investime të mëtejshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe logjistikën, me qëllim që të tërhiqen investitorë, të stimulohet turizmi dhe për të përmirësuar konkurrueshmërinë e ekonomisë.

Dispozitat që përcaktojnë ofertat e ulta anormale dhe në përgjithësi kuadri ligjor për prokurimin publik dhe koncesionet nuk janë plotësisht në linjë me *acquis*.

Kjo, bashkë me detyrimin për të bërë publik fondin limit nga autoriteti kontraktues, ngushton fushën për procedura konkurruese të përzgjedhjes së fituesit. Përqindja e procedurave jokonkurruese dhe jotransparente vazhdon të jetë e lartë.

Bazuar në fazat dhe proceset e zhvillimit të Shqipërisë në këta njëzetë e pese vitet e fundit dhe në dokumentet orientuese, nxitëse dhe ndihmuese të institucioneve ndërkombëtare për këtë qëllim, rezulton që ndër çështjet themelore dhe permanente për t'u zgjidhur nga politika, legjislativi dhe ekzekutivi shqiptar në mënyrë të përmbledhur, midis të tjerash, kanë qenë:

- Forcimi i Kapaciteteve Administrative, Zhvillimi Ekonomik e Social.
- Përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe progresi në reformën e sektorit financiar.
- Liberalizimi i kontratave publike në bazë të parimit të mos-diskriminimit dhe reciprocitetit.
- Ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet. Kjo, sidomos lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor vendas për prokurimin.
- Zhvillimi ekonomik në Shqipëri pengohet nga infrastruktura ende e keqe në transport, energji, dhe mjedis në shumë pjesë të vendit, si edhe nga mungesa e krahut të punës të kualifikuar. Prandaj, nevojiten investime të mëtejshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe logjistikën.
- Baza e prodhimit është përqendruar në pak sektorë me vlerë të shtuar të ulët në tregje eksporti të pakët.

- Duhet të forcohet sistemi Shqiptar për prokurimin publik, koncesionet dhe ankandin publik. Lidhur me këtë çështje komplekse duhet të zgjidhen një sërë problematikash të rëndësishme, si: Të zbatohet legjislacioni i prokurimit publik dhe të merren masa për ta përafruar plotësisht me standardet e BE-së.
- Respektimi dhe zbatimi në terren duhet të përshpejtohen nëpërmjet ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve të agjencive dhe institucioneve.
- Të forcohen më tej kapacitetet administrative të Agjencisë së Prokurimit Publik, njësisë të prokurimit publik në ministrinë e linjës dhe në qeverisjen vendore, si dhe të gjykatave që merren me prokurimin publik.
- Veçanërisht progresi në veprimtarinë e Agjencisë së Prokurimit Publik është jetik për përmirësimin e qeverisjes së sektorit publik, si një prioritet kyç i Partneritetit Evropian, dhe për përmbytjen e detyrimeve në kuadrin e MSA-së.

Në kushtet e kërkesave të larta për zhvillim të gjithanshëm dhe të shpejtë të ekonomisë dhe të shoqërisë shqiptare dhe, në kushtet e ekzistencës së burimeve të kufizuara, të nevojshme për të mbështetur këtë zhvillim, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, bazuar edhe në përvojat e vjetra dhe të reja të vendeve të tyre, i rekomandojnë Shqipërisë aplikimin e bashkëpunimit midis sektorit publik dhe atij privat në formën e koncesioneve dhe të tjera.

Sipas vlerësimeve të vazhdueshme deri në vitin 2011 të organizatave ndërkombëtare në dokumentat e sipërtreguara, rezulton që në Shqipëri duhen zgjidhur një sërë çështjesh, si:

- Kuadri ligjor për prokurimin publik dhe koncesionet nuk janë plotësisht në linjë me *acquis*.
- Nuk arrin të bëjë një dallim të qartë ndërmjet koncesioneve dhe kontratave të tjera publike.
- Përqindja e procedurave jo-konkurrese dhe jo-transparente vazhdon të jetë e lartë.

Politika, legjislativi dhe ekzekutivi shqiptar vazhdimisht, të udhëhequr dhe të drejtuar nga orientimet, udhëzimet dhe nxitjet e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, kanë përfshirë dhe zbatuar hap pas hapi këto porosi dhe udhëzime në programet e zhvillimit të Shqipërisë.

4.1 Bashkepunimi dhe mardheniet midis aktoreve në kontekstin e tranzicionit

Bashkepunimi dhe mardheniet midis aktorëve në planet arkitektonike dhe urbane, si dhe në projekte infrastrukturore të një shkalle më të vogël në Shqipëri po kalon një tranzicion dhe disa përpjekje janë bërë për të rregulluar mardheniet, parimet dhe praktikën e bashkepunimit në kontekstin e ri të ligjit civil.

Shteti, ka qenë autoriteti i vetmi burim nga i cili të gjitha planet dhe projektet zhvillimore janë iniciuar. Çdo veprim i shtetit gjenerohej nga planifikimi ekonomik qendror dhe ishte, në teori, e koordinuar plotësisht me veprime të tjera të nevojshme në një rend racional të kohës dhe burimeve. Shteti ishte personi juridik në të dy anët e marrëdhënieve themelore administrative, dhënia e lejes dhe "Zhvilluesi" në tjetrin krah.

Iniciativa për zhvillim tani del nga vendimet e marra nga një numër i personave të pavarur, investitorët, zhvilluesit, ndërtuesit, familjet, pronarët e tokave, si dhe administratat shtetërore, rajonale dhe vendore. Projektet propozohen tani në sekuencë logjike ose në koordinim me veprime të tjera.

Ndryshimet e fundit në ligjin shqiptar për 'Pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje' dhe mardhënien, rregullatoren e mardhënieve midis aktorëve në projektet zhvillimore, janë dëshmi se ligjvënësit, akademikët, profesionistët administratorë dhe planifikuesit po kuptojnë gjithnjë e më shumë problemet e tranzicionit.

Përshtatja me mekanizmat e reja të ligjit, rregullores dhe stimuljeve ekonomike po shkon teper ngadalë.

Por çfarë ndodh me Administratën Publike/Autoritetet lokale kur nuk kanë një plan të miratuar?

Në mungesë të një plani urban disa rekomandime:

"Vepra ndërsa planifikon – Act while planning"

1. Zhvillimi i kapaciteteve në Planifikim me pjesëmarrje, me përfshirjen e sa më shumë aktoreve të grupit të interesit

Procesi i bashkepunimit në planifikim të jetë me një përfshirje sa më të madhe, me qëllim që rezultati final të jetë i pranuar dhe i konsultuar me sa më shumë aktore.

"Sa më i suksesshem dhe afatgjatë"

Procesi i Bashkepunimit në Planifikim është një proces edukativ, që arrihet nëpërmjet tryezave të diskutimeve, midis komenteve të grupeve të ndryshme të interesit, komunitetit (perfaqësues sociale, perfaqësues ekonomike, perfaqësues etnik, kulturor etj) si dhe Autoriteteve Vendim Marrese.

Projektet kryesore të planifikuara deri në vitin 2030 . (Shqiperia 2030)

Ne dhjetor te vitit 2015, eshte prezantuar draft i “PLANIT TE PERGJITHSHEM KOMBETAR” (PPK), me qellim qe te garantojë zhvillim te qendrueshem territorial, ekonomik social dhe mjedisor te vendit. PPK strukturon dhe balancon zhvillimet ne territor dhe ofron nje klime te besueshme per investimet afatgjata. Ky plan i hap rrugen projekteve vendore te 61 bashkive te reja si dhe i jep fund epokes se 25 viteve te informalitetit ne Shqiperi. Ky plan mirepercakton se ku do te ndertohet dhe mbi c’kriteret do te zhvillohen keto zona.

PPK perbehet nga tre dokumenta te rendesishem:

1. Strategjia e zhvillimit te territorit dhe politika e saj
2. Plani
3. Rregullorja e planifikimit dhe zhvillimit

4.2 Ligjet. Baza per te drejten e pjesëmarrjes ne vendimmarrje.

E drejta e qytetarëve dhe e shoqërisë civile për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse nuk është një e drejtë që specifikohet saktësisht dhe shprehimisht nga Kushtetuta Shqiptare.

Kjo e drejtë rrjedh nga një sërë parimesh të sistemit politik demokratik të cilat garantohen nga Kushtetuta si : e drejta e lirisë për akses në informacionin publik apo e drejta për të propozuar ligje, e drejta e fjalës dhe e grumbullimit organizimit etj.

Ushtrimi i këtyre të drejtave rregullohet me anë të dispozitave kushtetuese e ligjore , akteve nderkombëtare , rregulloreve e udhëzuesve që sanksionojnë dhe rregullojnë zbatimin e këtyre të drejtave.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar një sërë konventash nderkombetare si : Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore; Te drejtën për informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje etj.

Keto akte ndërkombetare garantojnë të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor; të drejtën e organizimit; të drejtën për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit; të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrje;

Kuadri ligjor në republikën e Shqipërisë është në një linjë me të gjitha aktet e siperpermendura dhe në ligjet e rregulloret përcakton garantimin e shumicës së këtyre të drejtave.

Në vijim paraqitet një përmbledhje e kuadrit ligjor dhe rregullator në Republikën e Shqipërisë që garanton të drejtat e lirive themelore në funksion të pjesëmarrjes në vendimmarrje, menyrat dhe mekanizmat përkates.

Disa ligje dhe nene (shtojca):

5.1 Kushtetuta e Shqipërisë

Lirite dhe të drejtat vetjake.

Neni 23

E drejta e informimit është e garantuar.

5.4 Kuadri ligjor për të drejtën e shprehjes dhe të drejtën e informimit.

Shqipëria ofron garanci kushtetuese dhe ligjore të së drejtës së qytetarëve për të shprehur dhe informuar. Kater elementet që aftësojnë përfshirjen qytetare dhe të shoqërisë civile: grupet e organizuara, burimet, informacioni dhe negocimi, varen nga liria e shprehjes dhe e drejta për informim përmes të cilave njerzit mund të formojnë organizatë, mund të mobilizojnë burimet në mënyrë efektive, mund të kërkojnë dhenien e informacionit zyrtar apo debatojnë me qeveritë në nivel lokal dhe qendror.

Shqipëria është i pari vend në rajon që adaptoi legjislacionin për të siguruar qytetarëve të drejtën e informimit dhe aksesit në informacionin zyrtar nepermjet miratimit të Ligjit.

Ligji Nr. 8503, date 30.6.1999 “ Per te drejten e Informimit per Dokumentet Zyrtare”.

Vetem duke pasur informacionin e duhur dhe të saktë, qytetaret mund te diskutojne e të kërkojnë llogari mbi aktivitetin e qeverisë se tyre (qëndrore apo vendore) dhe shoqëria civile mund te jetë mjaftueshëm e informuar per ate që bëjnë qeverite dhe zyrtaret e tyre, me qellim bashkëpunimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit te tyre.

Nese liria e shprehjes eshte oksigjeni per angazhimin qytetar, e drejta e aksesit ne informacion eshte nje ushqyes thelbesor i ketij angazhimi te suksesshem.

Ligji Nr. 8503, date 30.6.1999 “ Per te drejten e Informimit per Dokumentet Zyrtare”

Neni 3

E drejta e informimit

Çdo person ka të drejte te kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kane te bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave qe ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar te shpjegoje motivet. Autoriteti publik është i detyruar te japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Cdo informacion për një dokument zyrtar, qe i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim te rastit kur ky informacion përbën te dhëna vetjake te vete personit, te cilit i është dhënë informacioni.

Neni 7

Format e dhënies se informacionit

Kërkuesit i vihet ne dispozicion një kopje e plote e dokumentit zyrtar, për te cilin kërkon te informohet. Autoriteti publik, me kërkesë te personit te interesuar ose duke sugjeruar vete, mund t'i ofroje kërkuesit forma te tjera te dhënies se informacionit, përfshi formën verbale. Ne çdo rast te tille, kërkuesi jep me shkrim pëlqimin për formën e ofruar.

Neni 8

Dokumentet zyrtare qe vihen ne dispozicion te publikut pa kërkesë

Autoriteti publik është i detyruar te bëje publike dhe te shumëfishojë vete, ne sasi te mjaftueshme dhe me formate te përshtatshme, dokumente qe lehtësojnë informimin e publikut për:

- a) vendndodhjen e organeve qendrore dhe vendore, vendet, si dhe emrat e punonjësve nga te cilët publiku mund te marre informacion, te paraqesë kërkesa apo te marre përgjigje;
- b) rregullat, procedurat dhe mënyrat se si mund te merren formularët e ndryshëm, shpjegime për qëllimin dhe përmbajtjen e tyre apo te dokumenteve dhe te vërtetimeve te nevojshme për plotësimin e formularëve;
- c) rregullat e përgjithshme ligjore, sipas te cilave vepron autoriteti publik, politikat e përgjithshme, qe zbaton autoriteti publik, si dhe ndryshimet e bëra ne to;
- ç) shpjegimet e detajuara për metodat dhe procedurat e punës se autoritetit publik.

Ligj Nr.8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverise Vendore”

Neni 34

Mbledhjet e hapura

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur.

Neni 35

Seancat e këshillimeve me bashkësinë dhe e drejta e publikut për t’u informuar

1. Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat “dh”, “e”, “f” dhe “k” të këtij ligji.
2. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore
3. Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim

Ligj Nr. 9355, dt 10.3.2005 “Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore”

Ndryshuar me ligjrt: nr.9602, datë 28.7.2006, nr.10 137, datë 11.5.2009, nr.10 252, datë 11.3.2010, nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 25/2013, datë 14.2.2013, nr. 47/2014, datë 24.4.2014, nr. 44/2016, datë 21.4.2016

Neni 29

Shtuar një paragraf në pikën 7 me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 44/2016, datë 21.4.2016

12. Miraton programe bashkëpunimi me OJF-të, institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në përputhje me nevojat dhe planet kombëtare e rajonale të ndihmës dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Rregulorja e punes se Kuvendit te Shqiperise Organizimi dhe Funksionimi i Kuvendit. Kreu VI.

Neni 36

Seancat dëgjimore publike

1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim.
2. Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, i paraqet të ftuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion.

4.3 Çështjet Institucionale

Analiza e marrëdhëniet institucionale, ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësi, ndikimin në koordinimin, zbatimin e vërtetë të programeve dhe projekteve dhe efikasitetit.

Ekziston një mungesë e koordinimit të prioriteteve mes pushtetit qendror dhe vendor dhe të aftësive të zbatimit. Kostot e përmirësimit të infrastrukturës janë të larta si rezultat i përdorimit të pakoordinuar të burimeve të fondeve vendore dhe ndihmëse. Është i nevojshëm bashkëpunimi në mes të qeverisë qendrore, dy apo më shumë juridiksione të Qeverisjes Vendore, dhe disa agjensive sektoriale.

Përveç kësaj, investimet e mëdha të infrastrukturës dhe projekte të ndjeshme mjedisore kërkojnë një bashkërendim në nivel metropolitan.

Konkludime:

Idetë, ose objektet e paprekshme të mendimit, përfshijnë vlera dhe ideologji. Ideja është një objekt i paprekshëm i mendimit. Vlerat janë besime të qëndrueshme mbi atë se cilat zgjedhje themelore në jetën personale dhe shoqërore janë korrekte. Rregullat, ose shprehjet, dhe normat kulturore bazohen mbi vlerat. Vlera është besim i qëndrueshëm mbi atë se cilat zgjedhje themelore të jetës janë korrekte.

Modeli i rrjetit të marrëdhëniesh tregon institucionin në qendër të një tërësie marrëdhëniesh të ndërsjellta me persona, me grupe dhe entitete të cilët quhen stakeholder/aktore pjesëmarrës. Aktoret pjesëmarrës historikisht shfaqen si ata të cilëve institucioni u sjell dobi ose dëme me veprimet e tij. Një institucion i madh ka shumë aktore pjesëmarrës. Ata mund të ndahen në dy kategori, në bazë të natyrës së marrëdhënies.

Aktore pjesëmarrës parësorë janë një numër i vogël elementësh për të cilët impakti i marrëdhënies është i menjëhershëm, i vazhdueshëm dhe i fuqishëm për të dy palët, si për institucionin, ashtu edhe për elementin. Ata janë aksionerët (pronarë), klientët, punonjësit, komunitetet dhe qeveritarët.

Aktoret pjesëmarrës dytësorë përfshijnë gamën më të gjerë të mundshme të elementëve në të cilët marrëdhëniet përfshijnë drejtëpërdrejtshmëri më të vogël të dyanshme, përfitim, dëm ose fuqi më të pakët për të influencuar.

Përfaqësuesit e modelit Stakeholder - aktore pjesëmarrës ndeshen dhe debatojnë për të përcaktuar se si të identifikojnë kush është ose çfarë mund të quhet një Stakeholder ose aktore pjesëmarrës. Duke e krahasuar situatën social-ekonomike dhe politike të Shqipërisë mund të arrihet në përfundimin që me Modelin Stakeholder – aktore pjesëmarrës, mund të përfaqësohet në mënyrën më pak të gabueshme

Në funksion të këtij përcaktimi do të duhet të gjykohet dhe mbi llojet e marrëdhënies reciproke që duhet të ekzistojnë midis elementeve bazë të fushës së studiuar: qeverisë dhe shoqërisë.

Siç do të tregohet në vijim të të gjithë punimit, filozofia më e përshtatshme dhe më e pranueshme për palët është ajo e pjesëmarrjes në vendim marrje dhe e partneritetit/ bashkëpunimit midis aktoreve të ndryshëm në projekte zhvillimore.

Qoftë në nivel qendror të shtetit, ashtu edhe në nivel të qeverisjes lokale, gjithnjë e më shumë po zhvillohet tendenca e kalimit nga sistemi i administrimit të vjetër publik (AVP) drejt sistemit të menaxhimit të ri publik (MRP).

Sipas këtij koncepti, kënaqja e nevojave dhe interesave të publikut, që përbën qëllim final të një shoqërie, do të mund të bëhet në nivelin më të mirë kohor, sasior dhe cilësor atëherë kur faktorët Qeveri-Shoqëri do të mund të bashkërendojnë interesat dhe veprimet e tyre në një partneritet afatgjatë.

Institucionet janë modele formale të marrëdhënieve që i bashkojnë njerëzit për të realizuar një qëllim. Ato janë thelbësore për të koordinuar punën e individëve që nuk kanë marrëdhënie personale me njëri-tjetrin.

Në shoqëritë moderne vërehen institucionet ekonomike, politike, kulturore, ligjore, të besimit fetar, ushtarake, arsimore, mjekësore dhe familjare. Ka institucione ekonomike të shumëfishta që përfshijnë institucionet financiare, formën e korporatës, tregjet etj.

Institucioni është një model formal i marrëdhënieve, që lidh njerëzit së bashku për të arritur një qëllim.

4.4 Reflektime mbi ligjin

Vihet re mungesa e korrektesise dhe transparences ndaj publikut, ne lidhje me perfshirjen ne proceset vendimmarrese. Mjetet e menytrat e parashikuara me ligj, nuk aplikohen sipas parashikimeve. Shtimi i kanaleve te komunikimit dhe perdorimi efektiv i tyre (vecanerisht komunikimi elektronik perms e-mail, faqe internet, media sociale etj, dixhitalizimi i sistemeve te informacioni te institucioneve, perdorimi i medias se shkruar dhe vizive lokale per transmetimin e informacioneve me interes publik (njoftime, thirrje interesi etj) jane disa masa qe duhen marre per permisimin e gjendjes ne kete drejtim.

Kuadri ligjor Vendas për prokurimin, duhet të përmirësohet. Pasojat në klimën e investimeve, për shkak të paqartësisë ligjore dhe dobësisë në zbatimin e ligjit, infrastrukturës së dobët, apo mos sigurimit të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike, pengojnë zhvillimin ekonomik.

4.5 Rregullat dhe institucionet

Ligjet nuk kanë qënë në gjendje të sigurojnë bazën për zhvillimin dhe për bashkëpunim institucional në mes të gjithë aktorëve.

Në 1993 shumë nga zhvillimet ishin informale dhe vështirë për tu ndaluar. Kjo krijoi dhe ende krijon probleme në zhvillimin e ardhshëm të vendit, për arsye se Pushtetit Vendor nuk ishte në gjendje për të mbajtur ritmin. Infrastruktura nuk është siguruar plotësisht.

Trashëgimia është bashkëpunimi i dobët ndërmjet strukturave të shtetit, dhe sistematizimin e drejtave mbi pronat.

Ndryshimet gjetën organizata rajonale dhe urbanistike të papërgatitura dhe jo në gjendje për të reaguar për të marrë pjesë në sistemin e ri.

Sistemi punon në bazë të dokumenteve të planifikimit ligjor. Rregullat dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse për bashkëpunimin në planifikim nuk janë të përcaktuara qartë.

Politikat, strategjitë dhe objektivat nuk janë të përcaktuar se çfarë duhet të bëhet në të ardhmen. Njerëzit e përfshirë në planifikim vuajnë mungesën e aftësive teknike dhe ata kanë qëndrim negativ drejt planifikimit. Planet nuk janë subjekt i konsultimeve dhe dëgjimit publik.

Pjesëmarrja nga sektori privat nuk është e inkurajuar. Informacioni i të dhënave është e munguar e cila çon në jo-transparencën. Personeli nuk janë të motivuar për shkak të mungesës së stimujve për shpërblime të tjera. Monitorimi është i dobët ndaj zbatimit të programeve-projekteve.

Nuk ka mbështetje të mjaftueshme financiare. Besueshmëria e planifikimit është përkeqësuar tashmë. Ka një mungesë të vizionit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Nuk ka integrim vertikal dhe horizontal në mes të organeve të planifikimit shoqëruar kjo me një proces të miratimit të centralizuar të planeve.

5 Njohja dhe studimi i eksperiencës shqiptare në procesin e bashkepunimit

Studime të 5 viteve të fundit tregojnë rritje të theksuar të pabarazive

- sociale
- ekonomike
- mjedisore
- hapsinore

dhe nevojën e pakundershtueshme të nderthurjes horizontale mes politikave sektoriale të ministrive, si dhe fuqizuar rolin e tyre.

Edhe pse i detyrueshem ligjrisht në Shqipëri, procesi i Bashkepunimit në Planifikim has rezistence, dhe vihet re dëshira e grupeve të interesit, madje edhe institucioneve për ta anashkaluar atë.



Vendimi:

- Berja e zgjedhjes ose zgjedhja nga dy ose me shumë alternativave

Procesi i Vendimmarrjes

- Identifikimi i problemit dhe kritereve për vendimmarrje
- Zhvillimi, analizimi dhe zgjedhja e një alternative për zgjidhjen e problemit
- Implementimi i alternativës së zgjedhur
- Vlerësimi i efektivitetit të vendimit

Arsyet referuar vendimmarrjes jane:

1. Njohuri ende te kufizuara ne planifikim. Bashkepunimi ne planifikim eshte shumedisiplinor dhe nje planifikues duhet te kete njohuri baze ne ekonomi, qeverisje, territor, mjedis, legjislacion, komunikim e politika sociale.
2. Mashtrimi nga “urgjenca”. Ne matricen “ e (pa) rendesishme – (jo) urgjente, pergjithesisht , zgjedhim ceshtjet urgjente, edhe nese jane te parendesishme , apo vendosim presion mbi ceshtje qe kerkojne kohe e pjekuri, mirepo urgjenca nuk na Lejon te shohim pasojat (afatgjata), dhe na erreson aftesine Vendimmarrese.
3. Mosbesimi tek produkti i procesit te planifikimit. Planifikimi kerkon kohe dhe planet nuk zbatohen gjithmone ashtu sic miratohen. Ne fakt, duhet kuptuar se edhe ndryshimi i planit gjate procesit te planifikimit apo pas miratimit te tij eshte planifikim.
4. Perceptimi se planifikimi eshte i veshtire dhe tejet teknik. Planifikimi trajton nje mori ceshtjesh dhe nderlikimesh sepse Vendimet e institucioneve ne raport me terrenin shpesh nuk perputhen. Mjafton nje grup teknik shume disiplinor dhe bashkepunues qe te analizoje e zgjidhe te gjitha ceshtjet teknike ne planifikim.
5. Miti i “interesave”. Suksesi i planifikimit si process e produkt bazohet tek negociata dhe komunikimi, por planifikimi bashkerendon interesa, madje shpesh edhe politikisht te nxehta. Sidoqofte, interesat mund te kenaqen me zgjidhje profesionale dhe te mirerenduara, pa nxituar ne Vendim Marrje te njeaneshme , kontradiktore e amatore .
6. Bllokimi nga koston. Ne llogarisim koston e kryerjes se procesit te planifikimit, (bazat e te dhenave per territorin, vizualizimin e tendencave te zhvillimit, hartimin e planeve, komunikimin publik etj.), por nuk llogarisim koston e mosrealizimit te ketij procesi. Ajo eshte mijra here me e larte sesa vlera financiare e te gjitha infrastruktureve publike ne territor dhe e shpenzimeve administrative per planifikim.

Në Shqipëri problemi nuk qëndron vetëm në faktin se është vështirësuar konteksti urban dhe ai i zhvillimit të territorit, por edhe në faktin se sistemi i planifikimit dhe instrumentet e tij ndryshojnë shpejt e vazhdimisht, pa pritur që praktikat përkatëse të konsolidohen. Në kushte të tilla, palët e interesuara të sektorit të planifikimit kanë nevojë për mjete ndihmëse që të përshtaten sa më mirë dhe të mos humbasin kohë në përvetësimin e ligjeve dhe rregullave të reja. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kushtet kur Shqipëria sapo ka *realizuar një reformë territoriale, si rezultat i së cilës 373 njësitë vendore të saj (urbane ose rurale) u zëvendësuan me 61 bashki*. Ulja e numrit të njësive vendore të qeverisjes nuk krijon vetëm mundësi për rritjen e ekonomisë së shkallës dhe efijencës në shërbime, por vendos edhe sfida të reja në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Hapësira administrative e çdo bashkie është rritur ndjeshëm, e po kështu edhe numri i popullsisë. Mbi të gjitha, kompetencat e autoriteteve vendore tanimë përfshijnë territore urbane dhe rurale (përfshirë ato bujqësore e natyrore), dhe kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në ngarkesën planifikuese dhe administruese të kryetarëve të rinj dhe stafit të tyre.

5 objektivat e politikës për periudhën 2014-2018:

- Modernizimi i sistemit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

- Planifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i territorit në çdo nivel dhe në integrim me çdo sektor;
- Mbyllja përfundimtare e epokës së informalitetit dhe vendosja e kontrollit mbi territorin;
- Fuqizimi i sektorit të strehimit social dhe përfshirja e integrimi i komuniteteve të pafavorizuara;
- Rritja e efikasitetit të energjisë në fushën e ndërtimit dhe në praktikën e planifikimit.

1. “Planifikimi i territorit është funksion i qeverisjes vendore”.
2. Në përputhje me planet strategjike të zhvillimit, çdo bashki do të hartojë dhe miratojë planet territoriale që do të jenë në harmoni me planet rajonale dhe me Planin e Përgjithshëm Kombëtar.

Ligji i ri për planifikimin e territorit i jep kompetencë ***bashkive dhe qarqeve*** për hartimin dhe miratimin e planeve të zhvillimit të territorit dhe lejeve të zhvillimit. Në zbatim të reformës territoriale do të rishikohen planet ekzistuese të zhvillimit të territorit. Do të sigurohet mbështetje financiare për autoritetet vendore për rishikimin e të gjitha planeve të tyre territoriale dhe bazën e të dhënave të krijuara për territorin e tyre.

Sipas nenit 29 të ligjit nr. 107/2014, kryetari i bashkisë është përgjegjës për “vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë”. Gjithashtu, kryetari i bashkisë jep certifikatën e përdorimit për ndërtimet e kryera mbi bazën e lejes së lëshuar prej tij. Sipas nenit 28 të ligjit 107/2014, kryetari i bashkisë jep certifikatën e përdorimit edhe për ndërtime të lejuara nga lejet e zhvillimit/ndërtimit të dhëna prej KKTsë, por vetëm pas një procesi bashkërendimi me autoritetet qendrore përkatëse. KKTja, gjithashtu, merr vendime për disa lloje lejesh zhvillimi e ndërtimi, për sa kohë që ato kërkojnë në terriore të cilësuar si “zona të rëndësishme kombëtare”, apo që kanë të bëjnë me zhvillime tepër komplekse dhe me ndikim kombëtar (p.sh. central prodhuese të energjisë, aeroporte etj., Sipas nenit 19, të VKM-së nr. 408

Mënyra të ndryshme të planifikimit, duke përfshirë edhe vendimmarrjen, janë ekzaminuar gjatë shekullit të kaluar. Pas epokës në të cilën atributet fizike të planifikimit ishin një shqetësim i madh për profesionistë dhe akademikë, planifikimi u riorientua nga ndërtimi i mjedisit fizik në ndërtimin e aspekteve intelektuale të planifikimit dhe në adresimin e të drejtave të grupeve të interesit dhe individëve.

Në fund të shekullit të 20-te, procesi i rritjes së zhvillimeve demokratike, politikave publike, dhe pjesëmarrja e publikut në vendim marrje kane përshkuar debate të forta.

Proceset demokratike dhe vendim marrese supozohet ti japin te drejta aktoreve pjesemarrres, rrjedhimisht detyra e projektuesve, planifikuesve, e profesionistëve bashkekohore tashme është perballja me sfidat e reja për justifikimin e proceset vendim marrese. (Faludi, 1987).

Problematikat dhe Gabimet (Struktura institucioneve, korrupsioni)

Në lidhje me natyrën e planifikimit (sipas shpjegimit të Almendinger)

"Planifikuesit nuk mund të veprojnë në një vakum i lirë. Egzistojnë rregulla, norma dhe procese ekzistuese " (Allmendinger, 2002, f. 17)

Gabimet njerëzore, problemet menaxheriale, kontradiktat në rolin e planifikuesit (edhe pse planifikuesit ende paraqesin veten si apolitike dhe teknikisht të ekspertëve, rreth 80 për qind e tyre janë të punësuar në sektorin publik, përmes të cilit ata janë të ngarkuar me kryerjen e politikave të preferuara të pushtetit qendror dhe lokal [për shembull, (Reade, 1987; Thornley, 1993; Blowers dhe Evans, 1997; Evans, 1995, 1993), egzistojnë dhe janë të pashmangshme.

Disa nga kontradiktat aktuale të planifikimit janë :

Ndjenjat personale dhe profesionale, Objektivat e punëdhënësit, dhe Kodi i etikës së institutit përfaqësues [Allmendinger, 2002, f. 23]).

Në këtë hulumtim, këto probleme shihen si pjesë e realitetit të planifikimit, në përgjithësi, dhe të vendimmarrjes, në veçanti. Prandaj, duke futur një mjet që është në gjendje të merren me këto lloje të paqartësive (përdorimi i llogjikës Fuzzy) është një pjesë e nënkuptuar e hulumtimit.

5.1 Aspekte te vendimmarrjes

Besides promoting democratic decision making by increasing opportunities for participation by citizens (Council of Europe, 1995), the creation of stronger local democratic institutions is increasingly being seen as a supply-side policy in the form of national capacity-building and institutional strengthening. (Bailey, 2001, p. 339)

Marrja e vendimeve është një proces kompleks. Kjo jo vetëm në planifikim, por edhe në fusha të tjera shkencore dhe teknike, është subjekt i debateve të gjata dhe të diskutueshme.

Në thelb, një nga fushat me të prekshme dhe interesante të njerëzimit. Ky sukses shkakton edhe ndjekjen e studimeve në Zhvillimin e inteligjencës artificiale (AI), një fushë frymëzuar nga njeriu, rreth aftësisë trurit dhe logjika e mendjes. Aplikimi i kësaj logjike, i ashtuquajturit logjika fuzzy, ka qenë zgjeruar gjatë 50 viteve të fundit.

- Cilat janë ngjashmëritë mes (natyrës së) së vendimeve logjike ne planifikim dhe logjikes fuzzy?
- A është përdorur kjo llogjike ne teoritë në planifikimin ?

Vendimmarrja dhe bashkepunimi ne planifikim

Ne Planifikimi urban, si ne cdo fushe tjetër vendim marrja nuk perben përjashtim. Ka shumë situata për të cilat duhen marre vendime, dhe autoriteteve perkatese u duhet ta iniciojne kete veprim.

Si Hopkins pohon: " Situatat vendim marrese janë zgjedhje në lidhje me veprimet per te cilat ne kemi kapacitetin, autoritetindhe mundesine e duhur per ta ndermarre. (Hopkins, 2001, p.30).

Kështu, aktivitete ose veprime të tilla duke gjykuar zgjidhjen dhe analizën cilësore do të egzistojne, ne permbushje te fazave te vendimmarrjes, si dhe post-veprim vlerësimin e tyre.

Autoritetet planifikuese dhe aktoret vendimmarres

Autoritetet planifikuese jane ata qe diskutojne nocionet, normat e planifikimit si profesioniste (Tekniket, akademiket) - VENDIM BERESIT, perkundrejt aktoreve te vendim marrjes te cilet nuk jane aspak te familjarizuar me termat teknike , por qe na fakt rezultojne perdoruesit e hapsirave planifikuese urbane.

Palët/grupet mund të jenë grupe të njerëzve të cilët janë të përfshirë ose në planifikimin ose ne procese te tjera te rendesishme. Anëtarët e grupit të parë janë të angazhuar me idenë e planifikimit si nje aktivitet, si nje detyre dhe anetaret e grupit tjetër jane thjeshte perfues nga planifikimi ose ata qe perballen me problemet e mundeshme.

Ne kete menyre te menduari, na duhet te shohim pertej faktit se duhet te perfshihen sa me shume grupime ne procesin e vendim – berjes dhe vendim- marrjes.

Këto grupe mund të kategorizohen në gjashtë etiketa dalluese:

1. Planifikuesit dhe institucionet planifikuese te perfshira ne aspektet teknike dhe shkencore, sic jane ekologjistet dhe gjeografet, urbanistet, arkitektet, inxhinjere etj.
2. Planifikuesit , institucionet dhe autoritetet qe kontrollojne fushat shkencore, politike, humane ekonomike dhe ligjore: te perfshiret ne strukturat pushtetare
3. Institucionet dhe agjensite te perfshira ne fushat humane si sociologe e psikologe
4. Institucione , agjensite, NGO, te perfshiret ne grupimet/organizatat jo fitim prurese
5. Grupet e biznesit qe jane te perfshire me shpenzimet dhe te ardhurat e tyre ne planifikim, te cilet shpesh jane propozuesit me skema variable.
6. Individet e afeksionuar nga planifikimi dhe vendim marrja

Keta grupe mund te ngrene zerin nepermjet organizatave te ndryshme , ne te gjitha proceset- vendim berese, vendim marrese pavaresisht nga fuqia dominuese e struktures.

5.2 Autoritetet vendimmarrese

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	AKPT
Agjencia e Legalizimit Urbanistik dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale	ALUIZNI
Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	AQTN
Instituti i Ndërtimit	IN
Enti Kombëtar i Banesave	EKB
Agjencia e Zhvillimit të Territorit	AZHT




Tabela 5.1: Autoritetet e planifikimit




Tabela 5.2: Autoritetet vendimmarrese Burimi, AKPT 2015




Tabela 5.3: Autoritetet vendimmarrese, Burimi, AKPT 2015
Rolet përkatëse dhe ndërvarësinë institucionale mes autoriteteve të planifikimit.
Ndërvarësia dhe marrëdhënia mes instrumenteve të planifikimit.

Varësia mes autoriteteve zbulohet në leximin e hierarkisë mes instrumenteve të planifikimit dhe të zhvillimit – pra, në dy aspekte:

- 1) kush i harton dhe kush i miraton dokumentet;
- 2) çfarë varësie ekziston mes dokumenteve.

Kështu, për shembull, plani i përgjithshëm vendor (PPV) miratohet fillimisht nga këshilli i bashkisë e më pas nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Këshilli i qarkut nuk ka kompetenca për miratimin e PPV-së, mirëpo përmbajtja e PPV-së duhet të përputhet e të mos jetë në kundërshtim me përmbajtjen e planit sektorial të qarkut. Gjithashtu, ministrinë nuk e kanë kompetencën e miratimit të PPV-së, por përmbajtja e PPV-së duhet të jetë në përputhje me planet sektoriale apo ndërsektoriale kombëtare që hartohen nga ministrinë.

Sigurisht, PPV-ja duhet të jetë në përputhje me PPK-në.

5.3 Format e bashkepunimit (Rast studimor Gjirokastra)

Gjirokastra është e njohur për historite, trashëgiminë, kulturën dhe karakterin e saj unik, si një thesar për mbare Shqipërinë. E ndodhur në Ballkan, në jug të Shqipërisë, Gjirokastra është dëshmi për pasurinë e trashëgimisë urbane dhe arkitektonike të këtij rajoni. Qyteti i Gjirokastrës është nën mbrojtjen e UNESCO-s që prej vitit 2005. Shume është shkruajtur për Gjirokastrën kohët e fundit, duke u fokusuar kryesisht në ruajtjen e ndertesave historike dhe për zhvillimin e turizmit, si mjet për të rigjallëruar qytetin e për të gjeneruar të ardhura.

Nga pikpamja urbanistike, qyteti formohet prej lagjeve dhe hapsirave publike, ku më kryesorja është pjesa e Pazarit, si edhe Kalaja e cila zë hapësirën qendrore në qytet. Lloji i banesës i jep tonin qytetit të Gjirokastrës, jo vetëm për predominancën në hapësirën e kësaj qendre, por edhe për kompozimin vertikal të theksuar, e që vetvetiu kompozon dhe siluetën e këtij qyteti. Banesa e Gjirokastrës zgjerohet në volum nga një kat në tjetrin, me qëllim që t'i adaptohet terrenit të aksidentuar shkëmbor element ky që sjell një zhvillim të pabarabartë të kateve. Këto shtëpi dallohen kryesisht për lidhjen perfekte me tokën mbi të cilën janë ndërtuar, diferencimin funksional sipas kateve, theksimin e karakteristikave mbrojtëse të tyre si dhe vendosjen funksionale. Shtëpitë i kanë catite me pllaka guri, në harmoni perfekte me peizazhin shkëmbor të territorit ku ato ngrihen.

Integriteti i përgjithshëm i qytetit është i kënaqshëm, edhe pse kjo është ndikuar negativisht nga ndërtimet pa leje në fund të viteve 1990. Origjinaliteti është gjithashtu i kënaqshëm, por menaxhimi për ruajtjen dhe mirembajtjen duhet të jetë më i madh, konkret dhe i zbatueshëm, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare. Masat e ndërmarra për menaxhimin dhe koordinimin e zbatimit të politikave midis sektorit publik dhe privat, duhet të nxirren sa më tepër Ruajtjen dhe Konservimin e vlerës së pronës, veçanërisht për sa i përket nderhyrjeve ndërtimore

Te kuptuarit e skemave të bashkepunimit

Shumë punë restauruese mbeten ende për t'u bërë në qytetin e Gjirokastrës, kjo si mundësi e theksuar e investimeve, publike apo private qofshin ato. Duke qenë se në këto rrethana një Model i vlefshëm dhe i suksesshëm mund të jetë përdorimi i skemave PPP, skema të Partneritetit Publik-Privat.

PPP (Funksionale)		
(D)BO T	(Design) Build (Finance) Operate (Transfer)	(Projekto) Nderto (Financo) Opero (Transfero)
(D)B OOT	(Design) Build Operate Own Transfer	(Projekto) Nderto Opero Transfero
DBFO (T)	Design Build Finance Operate (Transfer), Availability Payments Model	Projekto Nderto Financo Opero (Transfero)
(D)BO T	(Design) Build Operate Own, Transfer	(Projekto) Nderto Opero Vete, Transfero
DBL OT	Design Build Lease Operate, Transfer	Projekto Nderto Qira Opero Transfero
DBROT	Design Build Rent Operate, Transfer, Contracting Model	Projekto Nderto Qiran Opero, Transfer, Modeli Kontraktimit

Tabela 5.4: Perdorimi i skemave te partneritetit publik privat

PPPs (partenriteti publik-privat), mund te percaktohet si : Nje bashkepunim midis sektorit publik dhe zhvilluesve privat, te cilet " jane te vetedijshem se nuk mund t'ia dalin te vetem" (Sagaly, 2007, fq 8).

Ne kete menyre ndervaresia dhe bashkepunimi midis autoriteteve publike dhe sektorit privat (te tilla si kompani ndertimi, banka private, kompani investitore etj) kane si qellim: realizimin e nje projekti/ndertimi publik duke e financuar, ndertuar ose mirembajtur ate, ketu rreziku financiar i sektorit publik eshte pothuajse i reduktuar.

Domosdoshmeria per aplikimin e skemave te PPP- ve, lind si rezultat i fondeve te limituara publike, nga pamundesia per te permbushur nevojat e investimit te kerkuar, si dhe per rritjen e cilesise dhe eficences ne sherbimet publike. Një bashkëpunim më i mirë ndërmjet grupeve të interesit dhe autoriteteve vendore/lokale është një çështje urgjente per vlera te tilla historike.

Ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr 983, datë 10.11.2010 thuhet se: të gjitha institucionet vendore te cilat jane te lidhura me objekte te trashëgimisë kulturore janë nën përgjegjësinë e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Ky vendim i jep Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) të drejtë të propozojë një strukturë të re organizative, vecanerisht per aplikimin skemave dhe kontratave ku bashkepunojne sektori publik me sektorin privat.

IMK duhet të kujdeset dhe të shërbejë si "expertise body" (Referuar Legjislacioni Francez), duke pasur Autoritetin e plotë për të hyrë në negociatë me kontraktorin privat.



Tabela 5.5: Skema e Partneritetit Publik-Privat

IMK ka Autonomine e plotë për të ndërhyrë në procese të tilla si : Investimi/Financimi, Projektimi/Zbatimi, Operimi dhe Mirembajtja e aseteve të sektorit publik, ose të sigurojë shërbimin e nevojshëm ose të dëshirueshëm për të kontribuar në performancën e aseteve historike të qytetit.

Rastet dhe praktika të huaja në promovimin e trashëgimisë kulturore nepermjet partneriteteve publike private

Analiza dhe eksperiencia e rasteve studimore të mëposhtme, na vjen në ndihmë për të nxjerrë disa konkluzione për aplikimin e skemave të partneritetit dhe të tipeve të ndryshme të partneritetit. Te gjithë shembujt e ilustruara janë në listën e mbrojtjes nga UNESCO, skema të partneriteteve publike-private në nivele lokale, kombëtare apo ndërkombëtare. Këto partneritete shpesh janë të karakterit institucional, ku kompetencat e niveleve të ndryshme të administratës publike bashkohen, në të mirë të forcimit të proceseve administrative.

Rastet e paraqitura tregojnë domosdoshmërinë për të zhvilluar mjetet e planifikimit: mjete ligjore ekzistuese dhe skemat e menaxhimit të vlerësimit të trashëgimisë urbane, kur ato janë ende të pazhvilluara mirë dhe të pamjaftueshme të adresojnë konfliktin midis nevojave për një zhvillim urban të qëndrueshëm dhe ruajtjen e peisazhit qytetit.

Pengesat Ligjore shpesh rrjedhin nga mënyra se si Trashëgimia është perceptuar nga shoqëria në përgjithësi. Në Bergen (Norvegji), Zyra e Menaxhimit të Trashëgimisë (Norvegji) ka paraqitur *një skemë të detajuar operacionale* nëpërmjet një harte per çdo njesi të qytetit. *Skema e detajuar operacionale* është konsideruar nga autoritetet kombëtare dhe lokale si një mundësi për ruajtjen e trashëgimisë urbane.

Shpesh kjo tipologji qytetesh has ne veshtiresi per gjetjen e Fondeve. Ne vende te tilla si : Hollanda,Gjermania, Banka Boterore ze nje rol kryesor, nepermjet (SFD) Social Fund for Development, duke arritur te financoje godina te trashegimise.

Nje tjeter model i bashkepunimit eshte ai midis Frances dhe Kines, me qellimin e vetem per "Ruajtjen/Observimi e Arkitektures Kineze" ku " Qendra per Kerkime Kombetare" dhe "Shkolla e Arkitektures dhe Planifikimit - Shanghai" ne bashkepunim te ngushte me njera tjetren arriten prishmerite ne kete projekt

Ky program u mbështet nga te dyja qeverite e shteteve si dhe nga Unesco. Kohet e fundit jane marre edhe disa inisiativa te reja per ruajtjen e trashegimise boterore edhe per vendet ne tranzicion.

Projekti ne Vilnius (te Lituanise) perfshiu UNESCO-n, ICCROM-n, dhe Keshillin e Europes qe prej 1992. Aktivitetet rigjeneruese filluan gjate viteve 1992-95 dhe ndoqen nje perkrahje te gjere edhe nga komuniteti vendas.

Disa lloje partneritetesh

Partneriteti Nder - Institucional

Në Barcelonë, (Olimpiada). Kjo përvojë na tregon se si duke përfshirë aktorë nga sektorë të ndryshëm mund të arrihet konservimi, rikualifikimi dhe zhvillimi i vlerave të qytetit.

Bashkepunimi Nderkombetar

Bashkëpunimi ndërkombëtar ka qenë si trampolinë për ruajtjen e vlerave arkitektonike të objekteve. Studimet tregojnë se bashkëpunimi i dy qeverive Gjermane dhe Japoneze, për hartimin e udhëzimeve për ruajtjen e trashëgimisë të Georgetown (Penang, Malaysia) ishin të sukseshme. Ne të njëjtin vit, bashkia aprovoi edhe planin e zhvillimit, i cili i mori në konsideratë udhëzimet e mesiperme.

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve janë dy komponentet thelbësore të këtij partneriteti.

Bashkëpunim i decentralizuar

Aktivitetet e Trashëgimisë angleze ndahen në tre kategori kryesore (identifikimin e ndërtesave historike, arkitektonike dhe të monumenteve për mbrojtje; mbështetje e pronarëve dhe organeve institucionale; ndërgjegjesimi i komunitetit për të kuptuar dhe gëzuar trashëgiminë e tyre).

Është " Power of Space Agenda " ajo e cila ofron ide të reja për ruajtjen e politikave, sidomos për bashkëpunimin ndërmjet Autoriteteve lokale, Dhomes se Tregtisë, të Komunitetit dhe të Grupit të kishës.

Partneritete të tilla mund të sjellin ndryshime reale në promovimin e peisazhit historik në Liverpool .Projekti është rezultat i këtij partneriteti.

Konkludime:

Edhe pse studimet e ketyre rasteve tregojnë se sa të larmishme janë format e partneritetit, disa aspekte të rëndësishme mund edhe të nenvizohen.

- Një nga shqetësimet kryesore të iniciativave është lidhja midis "Zhvillimit Urban" dhe "Strategjite për Ruajtjen e Peisazhit historik të qytetit". Kjo lidhje është esenciale për të themeluar rregullore efikase si dhe për të nxitur partneritete efektive. Për të zgjidhur këto vijne në ndihmë "Negociatat midis interesave publike" dhe "Zhvilluesve urban", dhe nga ana tjetër "rritja e ndërgjegjesimit të komunitetit" dhe "forcimi i rolit të kultures" për një zhvillim urban kombëtar të qëndrueshëm.
- Çështja e dytë ka të bëjë me ekzistencën e një "Plani Urbanistik të miratuar". Ligjet dhe rregulloret shpesh janë të ngurta përballë një prone, pa marrë parasysh vlerën e saj, duke dështuar të sigurojnë bazën për ruajtjen e vlerave të saj.
- Së treti, vëmë re se si disa projekte janë të afta të integrojnë faktore urban, mjedisor dhe socialo - ekonomik , duke marrë në shqyrtim, qoftë edhe segmentet me të varfra të popullsisë.

Nepermjet ketyre përvojave arrihet të vendoset drejtësia sociale në një kontekst ku kombinohet "Ruajtja e Peisazhit Historik", "Vlerësimi i prone" dhe "Zhvillimi Urban". Marrëdhëniet midis Projekteve afatshkurtra, afat mesme dhe afatgjata janë një tjetër çështje e lidhur me Procesin e përgjithshëm të Bashkepunimit në Planifikim Urban.

Së fundi, një çështje e rëndësishme është "Besueshmëria" e një partneriteti. Ky i fundit mbështetet në marrëdhëniet midis institucioneve, grupeve të interesit dhe aktorët e tjerë operative.

Partneritetet e besueshme janë produkt i një ndërveprimi shoqëror që kërkon një zbatim të saktë të parimit kryesor " Trashëgimi i Perbashket dhe Përgjegjësi e Përbashkët". zbatuar dhe menaxhuar Projektin.

Në keto kushte " Ligji për trashëgimine kulturore "te cilit i referohet projekti në fjalë ,është shumë i përgjithshëm dhe i pamjaftueshëm për mbrojtjen e thesareve arkitektonike të qytetit. Nuk ka ligj/rregullore të detajuara që mund të orjentojnë.

Iniciativat e reja te partneritetit ne Shqiperi

Shqiperia po has veshtiresi ne adaptimin e partneritetit publik-privat kryesisht si pasoje e “pengesave ligjore”. Ligji dhe interpretimi i tij per PPP ne Shqiperi, i cili orienton autoritetet publike per te hyre ne negociata me autoritetet private, mungon. Rasti i meposhtem i analizes se tre objekteve ne qytetin e Gjirokastrës e ilustron me se mire kete fakt. Projekti eshte nje investim i qeverise Shqiptare dhe Unescos, i cili eshte implementuar ne vitin 2008-2010 nga projektues te Institutit te Monumenteve te Kultures. Mbikqyrja ka qene nga grupi IMK dhe zbatuesi nje kompani private, Shqiptare.

Ajo cka e diferencon aplikimin e nje skeme PPP nga ky rast eshte se : ne skemat PPP, te gjitha pjeset kontraktuale (projektimi, zbatimi, supervizimi, financimi, mirembajtja dhe operimi) jane te perfshira ne nje kontrate te vetme. Kjo lloj skeme, lehteson jo vetem veshtiresite e financimit publik, por shmang deshtimet e mundshme te bashkepunitimit midis aktoreve te ndryshem si dhe rreziqet serioze te menaxhimit ndaj vlerave te mirefillta arkitektonike te qytetit. Zakonisht afatet kontraktuale te ketyre skemave zgjasin 25-30 vjet mes. Nga ana tjeter vlen te theksohet se PPP-të nuk janë pa vështirësi. Ato janë shumë komplekse dhe te kushtueshme. Në disa raste, ato mund të jenë përtej kapacitetit të sektorit publik për ta.

Konkluzione dhe rekomandime

- Ndergjegjsimi i organeve vendore per rendesine e aplikimit te skemave PPP, ne menyre qe te shmangen rreziqet serioze te menaxhimit ndaj vlerave te mirefillta arkitektonike te qytetit.
- Politikat strategjike gjithëpërshiresë duhet te harmonizohen me mire qe te japin rezultatet e pritshme.
- Ndergjegjesimi i komunitetit lokal per statusin e trashegimise boterore.
- Organet pergjegjese duhet te inspektoje te gjitha institucionet lokale. Nje organ i tille mund te hartojë strategjite per te siguruar dhe mbrojtur peisazhin historik te qytetit.
- Mungesa e nje organi/ sistemi kontrollues per shmangien e ndertimeve pa leje.
- Nevoja e nje Plani Urbanistik per Rivitalizimin e qytetit te Gjirokastrës.
- Ruajtja e peisazhit duke gjetur mbeshtetjen dhe vullnetin politik është çelësi për të kuptuar historinë, modelet e zhvillimit, si dhe pasurinë kulturore të Gjirokastrës.




Figura 19: Fragmente nga projekti, rast studimor Gjirokastra

- Nje qender e vecante per shkembimin e informacionit duhet te krijohet, per te shtjelluar standartet e kontratave dhe zgjidhjet e detajuara ligjore.
- Duhet te iniciohet nje fushate mediatike duke shpjeguar idene dhe avantazhet e sistemit PPP ne ndertesat genuine arkitektonike.
- Transparenca duhet te jete principi paresor i aplikimi te skemave per nje menaxhimi sa me te mire te projektit.
- Deshifrimi i nje procedure specifike bazuar ne eksperiencat negative dhe pozitive te PPP.
- Krijimi i nje datebasi te detajuar me gabimet/metodat qe duhet te shmangen ne kete proces.

KAPITULLI 6

6 Studimi i inteligjences artificiale



Artificial = Nje krijese njersore qe nuk vjen natyrshem

Intelligence = Aftesi per te mesuar dhe per te aplikuar njohurite

Perdorimi i inteligjences Artificiale mund te eliminoje vartesit ose detyrat e perseritura.

Me ane te kesaj metode mund te perftohen Vendimmarrje te cilat kane variacione perceptuale, Metoda e cila realizon transformimin e koncepteve jo intuitive, ne te matshme dhe konkrete.

Ekzistojne disa forma te inteligjences artificiale. Nje nga me te suksesshmet jane rrjetat neurale. Keto bazohen ne llogaritjet paralele dhe jane sot nje fushe e ethshme kerkimi. Rrjetat neurale imitojne ne menyre te thjeshtuar principet fiziologjike te trurit te njeriut. Pra ka disa neurone qe lidhen me njera tjetren me ane te sinapseve. Cdo sinaps dergon impulset nga nje neuron tek tjetri. Nga ana tjetere cdo impuls qe dergohet nga nje neuron tek tjetri peshohet nga ky i fundit ne baze te rendesise qe ka ky sinaps. Pra deri diku vleresohet forca e lidhjes mes dy neuroneve me ane te "peshimit" te lidhjes.

Ideja inovative ne kete drejtim eshte perlllogaritja paralele. Ne konceptin tradicional te analitikes dhe kompjuterit ekziston nje fluks informacioni qe kalon ne disa stade. Nese mungon nje stad (psh memoria RAM ne kompjuter) atehere elaborimi ka falimentuar. Ndryshe nga kjo ide seriale rrjetat neurale imitojne nje paralelizem te perlllogaritjes ku pikat fituese jane dy. Se pari mund te priset nje neuron ose grup neuronesh pa kompromentuar te gjitha funksionimin. Kjo ngjan efektivisht me trurin tone. Se dyti, mund te gjenden solucione per probleme jo lineare. Pra se dyti mund te gjenden rregulla te brendshme ne nje bote kaotike ne dukje.

Rrjetat neurale perdoren si ne inxhinieri, per te realizuar software te fuqishem (njohjen e zerit te dikujt, diktimin e nje teksti ne kompjuter, njohjen e germave nga nje fotografi etj) ashtu edhe ne psikologji, per te imituar funksionimin natyral te trurit (rruga e dyfishte e shikimit, riprodhimi i neuroneve te lobit ocipital, riprodhim i elaborimit audio qe ben truri ne zona te caktuara, etj). Ka patur tentativa per te krijuar software qe mund te japin diagnozen e nje pacienti ne baze te simptomave (pra te zevendesojne mjekun deri diku). E gjithë kjo do te thote se ky sektor eshte me shume perspektive.

Shqyrtimi i studimeve ekzistuese, analizat krahasuese, udhëzimet, modelet, instrumentet dhe studimet e rastit kanë qenë burime të vlefshme për të vendosur se cilat praktika më të mira duhet të paraqiteshin në këtë dokument.

Kohet e fundit, zhvillimi I teknologjise inxhinjerike kerkon nga hulumtuesit qe te hulumtojne dhe zbulojne mjete me te mira per jeten e perditshme.

Algoritmet e rregullimit Fuzzy-Neural, jane mjaft terheqes dhe kane zgjeruar interesim te larte tek hulumtuesit, bazuar ne potencialin ne zhvillim e siper te tyre, ne aspektin e operimit me strukture komplekse dhe parametra te papercaktuar te modelit matematikor.

Koheve te fundit verehet rritje e interesimit te cilat bazohen ne parimet e evolucionit natyror. Gjithashtu jane duke u zhvilluar metoda te mesimit te cilat projektimin e rregullatorit e bejne ne menyre automatike, perms algoritmeve gjenetike.

Orjentimet qe kane te bejne me rregullatoret Fuzzy Logjik dhe Rrjetat NeuraleArtificiale.

Trend, I cili eshte ne rritje e siper, (citat nga : Matlab/Fuzzy Logic Toolbox), eshte perdorimi i

FL – Fuzzy Logjikut (Fuzzy Logic)ne kombinim me

ANN – Rjetat Neurale Artificiale (angl: Atrificial Neural Network) dhe

GA – Algoritmet Gjenetike (ang: Genetic Algorithm)



Mendo – vepro ne menyre humane;
Mendo – vepro ne menyre racionale;

Gjurmet e para - Ne Greqine e lashte

- **Lotfi Asker Zadeh (1965)** – I pari qe botoi idete e llogjikes Fuzzy
- **Professor Toshire Tarano (1972)** – I pari qe punoi me sistemet Fuzzy
- **F.L. Smidth & CO (1980)** - I pari qe eksperimentoi ne Fuzzy expert syste

Ne pergjithesi , FL-te, ANN-te, dhe GA-te ndoshta do te jene themelet e te ashtuquajtures SOFT COMPUTING – SC (programmim I bute), i cili ka per qellim pershtatjen me boten reale, ndryshe nga programimi i forte (hard computing).

Ne te ardhmen SC- programimi i bute duhet te luaje rol te rendesishem ne konceptin dhe dizajnin e sistemeve, tek te cilat Inteligjenca Artificiale do te jete shume me e perparuar se ato te projektuarat me metodat konvencionale.

Madhesia e Rjetes Neurale nenkupton numrin e teresishem te neuroneve qe do te perdoren. Nga njohurite tona, **percaktimi i madhesise se rrjetes behet me teper me eksperimentime – simulime kompjuterike.**

Teoria e pergjithesimit te kesaj problematike eshte duke u zhvilluar. Problematika eshte si ne vijim: Numri i neuroneve ne shtresen e fshehte eshte i shoqeruar me shtresen hyrese ne njeran ane dhe ate dalese ne anen tjeter.

Artificial Neural Networks (ANNs)




Fig.2. Typical three-layer architecture of a feed-forward ANN.

Numri i madh i neuroneve - rrjeta rezulton me numer te madh te operacioneve matematikore, rezultat rrjeta e ngadaleshme.

Nese merret numer i vogel i neuroneve, rrezikojme te fitojme rezultate kunderthenese, te padeshiruara etj.

Bazuar ne hulumtimet, punimet shkencore te nivelit kombetar dhe nderkombetar, qe kemi arritur ngritem tezen se : Madhesia e ANN-ve duhet te percaktohet me perdorim te algoritmeve gjenetike e “ndoshta”, te nderhyhet edhe me thelle ne nderlidhjet e neuroneve te saj, qe eshte prezantuar ne kete punim.

Qellimi i ketij punimi eshte tendenca e projektimit te rregullatoreve per rregullimin e punes se procesit te vendim marrjes.

Bazat teorike të logjikës fuzzy, nocionet themelore të saj, bashkësitë fuzzy dhe veprimet me to, pohime dhe rregulla të këtyre bashkësive. Teoria e logjikës fuzzy mund të shihet si një përgjithësim i teorisë së logjikës klasike, prandaj fillimisht jepen njohuritë themelore të logjikës klasike (boolean), si një referencë për zhvillimin e teorisë së logjikës fuzzy. Në fund të kapitullit është ilustruar funksionimi i sistemeve fuzzy dhe janë përshkruar karakteristikat e dy sistemeve themelore fuzzy: Sugeno dhe Mamdani.

6.1 Teoria fuzzy, kuptimi dhe nocionet

Përshkrimi i logjikës fuzzy Logjika fuzzy ka dy kuptime të ndryshme. Në një këndvështrim të ngushtë është një sistem logjik. Në një kuptim më të gjerë është sinonimi i teorisë së grupeve fuzzy, e cila u referohet bashkësive të objekteve që kanë kufij të papërcaktuar, dhe të qenit pjesë e këtyre bashkësive përcaktohet në nivele sasiore në përqindje. Pra, një element mund të jetë pjesë e një bashkësie, pjesërisht mund të shmanget vlerësimi, është plotësisht apo s'është fare. Këtë e shpreh teoria fuzzy. Dhe në kuptimin e parë, logjika fuzzy ndryshon në koncept dhe në substancë me sistemet logjike tradicionale.

- Në këtë studim, **logjika fuzzy** do të studiohet në raport me teorinë e **grupeve fuzzy**.
- Kjo metode ka si vecanti përdorimin e **variablave linguistikë**, të cilët kanë si parametra fjalët dhe **jo numrat**.
- Edhe pse fjalët janë më pak të sakta se numrat, përdorimi i tyre qëndron më afër intuitës njerëzore.
- Rregullat Fuzzy janë të ndërtuar në formën "**Nëse-Atëherë**"
- Mekanizmi që bën lidhjen e shkakut me pasojën quhet **Varësia Fuzzy** dhe Gjuha e Komandës (**FDCL** - Fuzzy Dependency and Command Language).



Në këtë studim, logjika fuzzy do të studiohet në raport me teorinë e grupeve fuzzy. Kjo logjikë ka si vecanti përdorimin e variablave linguistikë, të cilët kanë si vlera apo parametra fjalët dhe jo numrat. Kjo metodë përdor për llogaritje fjalët dhe jo numrat. Edhe pse fjalët janë më pak të sakta se numrat, përdorimi i tyre qëndron më afër intuitës njerëzore. Një veçanti në përdorimin e logjikës fuzzy është përdorimi i rregullave fuzzy. Ato janë të ndërtuar në formën "Nëse-Atëherë". Sistemet e bazuara në rregulla kanë gjetur përdorim të gjerë në Inteligjencën Artificiale, por ajo që u mungon këtyre sistemeve është një mekanizëm që bën lidhjen e shkakut me pasojën. Ky lloj mekanizmi është ndërtuar në sistemin fuzzy. Ky mekanizëm quhet Varësia Fuzzy dhe Gjuha e Komandës (FDCLFuzzy Dependency and Command Language). Arsyeja e përdorimit të logjikës fuzzy qëndron në relativitetin e rëndësisë së një përgjigjeje ekzakte: Sa e rëndësishme është të marrësh një përgjigje ekzaktësisht të saktë, kur mund të nevojitet një përgjigje e përgjithshme?

Edhe pse logjika fuzzy është metodë e re, koncepti i aplikimit të saj bazohet në arsyetimin e njeriut, që është një aftësi e hershme. Parë në këtë këndvështrim, logjika fuzzy mund të konsiderohet metodë e re dhe e vjetër. Në logjikën fuzzy vihet në balancë saktësia dhe kuptimi i përgjithshëm i një përgjigjeje.

ne bazen e saktësis dhe kuptimit ne praktike




Figura 20: Saktësia kundrejt kuptimit ne praktike

Logjika fuzzy është një mënyrë e përshtatshme, ku nëpërmjet vlerës së inputit tregohet output i duhur. P.sh, në bazë të Sasisë Totale të Gazeve të Djegshme (TDCG) në vajin e transformatorit, logjika fuzzy të tregon masat që duhen marrë ndaj transformatorit. Në figurën e mëposhtme është ilustruar marrëdhënia e inputit me outputin në logjikën fuzzy.




Figura 21: Hapësira që zë inputi dhe outputi.

Për të përcaktuar masat e duhura që duhen marrë ndaj transformatorit, nevojitet një lidhje e saktë ndërmjet inputeve dhe outputeve. Midis tyre tregohet një kuti e zezë që realizon lidhjen. Kjo kuti mund të jetë: sistem fuzzy, sistem ekspert, sistem linear, rrjet neural, ekuacione diferenciale etj. Arsyeja pse kjo kuti duhet të jetë sistem Fuzzy vjen nga vetë krijuesi i këtij sistemi, Lotfi Zadeh, i cili thotë: "Në cdo rast mund të merret i njëjti produkt pa përdorur Logjikën Fuzzy, por kjo logjikë është më e shpejtë dhe më e lirë se sistemet e tjera".

PARAQITJA E LLOGJIKES FUZZY



Figura 22: Paraqitja e llogjikes FUZZY

Vlerat e përdorimit të Logjikës Fuzzy

Më poshtë është renditur një listë me vlerësimet që i janë bërë logjikës fuzzy:

Konceptet themelore të këtij sistemi janë të lehta për t'u kuptuar. Arsyeimi që ndjek kjo metodë bazohet në koncepte të thjeshta matematikore.

Logjika fuzzy është fleksibël si sistem. Mund të bashkëveprojë me lehtësi me sistemet e tjera.

Është sistem tolerues ndaj të dhënave që kanë një shkallë pasaktësie.

Logjika fuzzy mund të modelojë funksione jolineare me shkallë të lartë kompleksiteti.

Mund të ndërtohet një sistem fuzzy që mund të funksionojë me _do lloj të dhënash si inpute dhe outpute.

Një sistem fuzzy mund të ndërtohet duke u bazuar në njohuritë e ekspertit të fushës.

Logjika fuzzy mund të punojë në harmoni të plotë me teknikat tradicionale të kontrollit. Këto të fundit, duke u shtuar logjikën fuzzy, bëhen më të lehta për të zbatuar.

Përdorimi i logjikës fuzzy bazohet në gjuhën e thjeshtë të komunikimit. Kjo e bën këtë sistem të lehtë për t'u përdorur. Vlerësimi i fundit i bërë ndaj sistemit fuzzy është më i rëndësishmi

Një këndvështrim i përgjithshëm i sistemit Fuzzy

Principi kryesor i logjikës fuzzy është përcaktimi i marrëdhënieve midis inputeve dhe outputeve, dhe kjo bëhet nëpërmjet rregullave të formës "Nëse-Atëherë". Të gjitha rregullat zbatohen në paralel në raport me njëra-tjetrën dhe renditja e tyre është e parëndësishme. Rregullat u referohen variableve dhe mbiemrave që përshkruajnë këto variabla. Përpara se të ndërtohet një sistem që bën interpretimin e rregullave, si fillim duhen përcaktuar termat që do të përdoren dhe mbiemrat që do t'i përshkruajnë ato. Për të thënë që uji është i nxehtë, duhet përcaktuar intervali i ndryshimit të temperaturës së ujit, si dhe duhet përcaktuar kuptimi i fjalës "i nxehtë". Diagramat e mëposhtme tregojnë procesin e vlerësimit të logjikës fuzzy.




Figura 23: Ilustrim i përgjithshëm i Logjikës Fuzzy

Në figurën e sipërme, përvec rastit të përgjithshëm kemi edhe një rast specifik. Ai është shkëputur nga metoda Key Gas Method, e cila bën vlerësimin e gjendjes së transformatorit në bazë të sasive individuale të gazeve kryesore. Në figurën e mësipërmetregohet se si ndikon sasia e gazit H2 në gjendjen e transformatorit. Pra, vlerësimi fuzzyështë një metodë që interpreton vlerat e vektorit të inputeve dhe bazuar në grupin e rregullave përcakton vlerat e vektorit të outputeve.

Bashkësitë logjike Fuzzy dhe veprimet me to

Logjika fuzzy mund të shihet si një përgjithësim i teorisë logjike klasike. Duke ndjekur këtë arsyetim, është e nevojshme që disa njohuri të logjikës klasike të paraqiten shkurtazi, për të siguruar vijueshmërinë e materialit.

Bashkësitë logjike klasike

Një bashkësi klasike (boolean) **A** përbëhet nga elementet e një super bashkësie **X** ($x \in X$), e quajtur bashkësia Univers ose **Universi**. Bashkësia **A** kënaq konditën specifike $A \in X$. Një bashkësi është përcaktuar me anë të funksionit të saj të anëtarësisë (quajtur ndryshe karakteristika ose shkalla e vërtetësisë) $\mu_c(x)$:

$$\mu_c(x) = \begin{cases} 1 & \text{kur } x \in A \\ 0 & \text{kur } x \notin A \end{cases}$$

Ky funksion shpreh që një element x i bashkësisë Univers i përket plotësisht ose nuk i përket bashkësisë A .

Funksioni i anëtarësisë është quajtur shpesh *funksion anëtarësie* ose *funksion anëtarësie zero-një* me referencë dy vlera të vetme që mund të pranohen.

Funksione të tilla binare mbështeten nga logjika klasike (boolean), në të cilën anëtarësia totale në një bashkësi është paraqitur nga 1 (e vërtetë), përjashtimi total nga 0 (e pavërtetë).

Kjo tregon që kalimi midis dy bashkësive fqinje të universit të diskutimit është i prerë.

Veprimet mbi bashkësitë klasike

Kemi dy bashkësi A dhe B të përcaktuara në bashkësinë Univers X . Veprimet themelore me këto dy bashkësi janë paraqitur si më poshtë: produkti kartezian, plotësi, diferenca, ndërprerja, bashkimi. Këto mund të jenë përcaktuar duke iu referuar funksioneve të anëtarësisë:

Produkti kartezian	$A \otimes B = \{(x, y) x \in A \text{ e } y \in B\}$	$\mu^{A \otimes B}(x, y) = \mu^A(x) \mu^B(y)$ ($x \in A, y \in B$)
Plotësi i A	$\tilde{A} = \{x x \notin A\}$	$\mu^{\tilde{A}}(x) = 1 - \mu^A(x)$ ($x \in A$)
Diferenca	$A - B = \{x x \in A \text{ e } x \notin B\}$	
Ndërprerja (AND logjik)	$A \cap B = \{x x \in A \text{ e } y \in B\}$	$\mu^{A \cap B}(x, y) = \min[\mu^A(x), \mu^B(y)]$ ($x \in A, y \in B$)
Bashkimi (OR logjik)	$A \cup B = \{x x \in A \text{ o } y \in B\}$	$\mu^{A \cup B}(x, y) = \max[\mu^A(x), \mu^B(y)]$ ($x \in A, y \in B$)

Veprimet e mësipërme bazohen në dy principe jo kontradiktore të logjikës klasike.

Principi i parë pranon që një element x nuk mund t'i përkasë njëkohësisht një bashkësie A dhe plotësit të saj $A^{\sim}$, pra ndërprerja e A dhe $A^{\sim}$ është zero dhe jep bashkësi boshe:

$$A \cap \tilde{A} = \emptyset$$

Ndërsa i dyti pranon që bashkimi i një bashkësie A me plotësit të saj $A^{\sim}$ jep universin e diskutimit X :


$$A \cup \tilde{A} = X$$

6.2 Sfondi teorik. Parimet baze të modelit "Fuzzy Logic".

Platoni hodhi themelet për atë që më pas do të njihet si Llogjika Fuzzy, duke treguar se ekziston një pjesë e tretë, përtej "të vërtetës dhe jo të vërtetës", ku këto të kundërta "vertiten".

Në fillim të viteve 1900, Lukasiewicz pershkroi një llogjikë tre-vlereshe. Vlerën e tretë ai e propozoi se mund të perkthehet me termin "e mundshme" dhe ai e percaktoi atë me një vlerë numerike në mes të asaj të "vërtetë" dhe asaj "falso". Përfundimisht, ai propozoi një simbolike

te tere dhe sistemin aksiomatik. Me vone ai hulumtoi llogjiken kater-vlereshe dhe llogjiken pese- vlereshe dhe me pas deklaroi se ne parim nuk kishte asgje per te parandaluar derivimin e nje llogjike te tille ne vlera te pafundme. Lukasiewicz mendonte se llogjika tre –vlereshe dhe llogjika pafund–vlereshe ishin me intriguese, por ai u vendos perfundimisht ne nje llogjike kater-vlereshe, sepse ajo ju duk te jete me e lehte dhe me e adaptueshme me llogjiken Aristoteliane. . Deri koheve te fundit nuk eshte mbajtur ne konsiderate nocioni i llogjikes se vlerave te pafundme. Por ne vitin 1965 A.Zadeh publikoi punen e tij te quajtur "Fuzzy Sets " i cili pershkron teorine matematike te bashkesive (grupimeve) Fuzzy. Kjo teori e propozuar ka bere qe funksioni i anetaresise (pra vlerat e verteta dhe jo te verteta) te veprojne mbi nje varg numrash reale qe shtrihen ne segmentin $[0.0, 1.0]$.



Rendesia e Llogjikes Fuzzy.

Rendesia e llogjikes Fuzzy rrjedh nga fakti se menyra e arsyetimit njerezor dhe sidomos sensi i arsyetimit kane natyre te perafert. Keto jane karakteristikat thelbesore te llogjikes Fuzzy :

- Ne llogjikes Fuzzy, arsyetimi i sakte eshte pare si nje rast kufizimi i arsyetimit te perafert.
- Ne llogjiken Fuzzy gjithcka eshte nje ceshtje e shkallezimit /antaresimit
- Cdo sistem llogjik mund te fuzzifikohet
- Ne llogjiken Fuzzy, njohja eshte interpretuar si nje koleksion elastik apo si nje permbajtje e ne nje koleksion fuzzy te variablave.

Kohet e fundit, zhvillimi i teknologjise inxhinjerike kerkon nga hulumtuesit qe te thellohen dhe te zbulojne mjete me te mira per jeten e perditshme. Algoritmet e rregullimit Fuzzy-Neural, jane mjaft terheqese dhe kane zgjeruar interesim te larte tek hulumtuesit, bazuar ne potencialin ne zhvillim e siper te tyre, ne aspektin e operimit me strukture komplekse dhe parmametra te papercaktuar te modelit matematikor.Trend, i cili eshte ne rritje e siper [9]. eshte perdorimi i FL – (Fuzzy Logic) ne kombinim me ANN – (*Artificial Neural Network*) dhe GA – *Genetic Algorithm*

Ne pergjithesi, FL-te, ANN-te, dhe GA-te ndoshta do te jene themelet e te ashtuquajtures SOFT COMPUTING – SC (programmim i bute), i cili ka per qellim pershtatjen me boten reale, ndryshe nga programimi i forte (hard computing). Ne te ardhmen SC- programimi i bute duhet te luaje rol te rendesishem ne konceptin dhe dizajnin e sistemeve, tek te cilat Inteligjenca Artificiale do te jete shume me e perparuar se ato te projektuarat me metodat konvencionale. Madhesia e Rjetes Neurale nenkupton numrin e teresishem te neuroneve qe do te perdoren. Nga njohurite tona, percaktimi i madhesise se rrjetes behet me teper me eksperimentime – simulime kompjuterike.

Problematika eshte si ne vijim: Nese merret numer i vogel i neuroneve, rrezikojme te fitojme rezultate kunderthenese, te padeshiruara.

6.3 Artificial Neural Networks (ANNs)

Bellman dhe Zadeh ishin te paret qe shqyrtuan problemin e vendim marrjes ne nje mjedis Fuzzy, dhe kumtuan nismen e FMCDM (A fuzzy multi-criteria decision making method) Keto metoda analizuese jane perdorur gjeresisht me problemin e vendim marrjes, me kriteret e shumta te vleresimit /perzgjedhjen e alternativave.

Aplikacionet nga literature e huaj, vijne nga fusha te ndryshme si: perqasje per planifikimin dhe projektimin ne perzgjedhje tenderash per godina publike .

Strategjia e Transferimit te teknologjiese ne bioteknologji .

Optimizimi i projektimit te kamioneve.Vendim marrjet e ndryshme ne furnizimin me energji, alternativat e investimit te transportit urban, vleresimi i rrezikut turistik, vleresimi i strategjive te marketingut elektronik, ne industrine e sherbimeve, perzgjedhja e vendndodhjes se restoranteve, vleresimi i qendrave te shperndarjes etj.

Vendimmarrësit shpesh kanë një detyrë shumë e vështirë, sepse ata kanë për të analizuar sasi të madhe të informacionit dhe ata kanë një kohë shumë të kufizuar për të marrë vendimin. Investimet afatgjata si për shembull vleresimi apo edhe blerja e nje kompleksit të ri ndërtimi ose percaktimi i nje sheshi landfilli, kanë rëndësi strategjike. Këto investime kërkojnë një sasi të konsiderueshme të burimeve dhe vendimet e pasakta janë teper të kushtueshme.

Ndaj ne keto raste del nevoja për hartimin e metodave të reja të sofistikuara që lehtësojnë procesin apo mbledhjen e te dhënave, analizën dhe vlerësimin e tyre. Ka një dallim të madh në mes të fushave të ndryshme të shkencës. Për shembull matematikë dhe fizikë kanë variabla të sakta, ndersa shkencat shoqërore si për shembull ekonomi kanë të variabla te ndryshueshme, por më vështirë eshte për ti matur dhe vlerësuar këto variabla.

Logjika fuzzy lejon kërkuesit të punojnë me variablat pasakta ose edhe të panjohura që shpesh mund të gjenden në planifikime urbane , ekonomi ose në vendimet për investime te ndryshme.

Ky simulim fokusohet në zbatimin e logjikës fuzzy si një vendimmarrje, mbështetje jo vetem për investitorët të cilët planifikojnë të zhvillojne por edhe per perfituesit e ketij investimi.. Për shkak të një shkallë të lartë dhe komplekse të problemit të vendim-marrjes - qëllimi i këtij hulumtimi është për të hartuar një metodë që lehtëson përdorimin e logjikës fuzzy në në fushën e ndertimit dhe planifikimit arkitektoniko urban.

Metoda e propozuar është e bazuar në përdorimin e logjikës fuzzy, modelimin, analizen statistikore dhe metodat e sofistikuara të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit. Metoda e re lejon vendimmarrësit të procesit sasi shumë më të mëdha të informacionit dhe të vlerësojë alternativat e mundshme përprojektimin në mënyrë efikase.

Keto studime tregojne avantazhet ne trajtimin dhe vleresimin e kriterëve dhe nxjerren e rezultateve mjaft te besueshme.

FMCDM eshte nje metode analitike per te vleresuar perparësitë dhe mangësitë e alternativave te bazuara ne kriteret e shumta te projektimit urban. Problemet e FMCDM mund te klasifikohen gjersisht ne dy kategori: "Programimin e kriterëve te shumta" dhe "Vleresimin e kriterëve te shumta"

Perderisa studimi i marre ne shqyrtim eshte kryesisht i fokusuar ne Problemin e Vleresimit, i eshte vene theksi "Vlersimit te kriterëve te ndryshme ne projektim". Tipike per vleresimin e kriterëve te shumta eshte shqyrtimi i nje grupi alternativash te realizueshme, i cili konsideron me shume se nje kriter per te percaktuar nje renditje prioritare per zbatimin e alternatives. Keto jane pese parime te cilat jane marre ne konsiderate gjate formulimit te kriterëve:

- Plotësia e kriterëve
- Aftësia operative
- Kompostimi i kriterëve, zberthimi i prioriteteve nga hierarkia me e larte ne ate me te ulet.
- Shmangia e kriterëve te perseritura
- Kriteret te mirepercaktuara

Në këtë material, Llogjika Fuzzy do të studiohet në raport me teorinë e "Grupeve Fuzzy". Kjo logjikë ka si veçanti përdorimin e variablave linguistikë, të cilët kanë si vlera apo parametra fjalët dhe jo numrat. Edhe pse fjalët janë më pak të sakta se numrat, përdorimi i tyre qëndron më afër intuitës njerëzore. Arsyeja e përdorimit të Logjikës Fuzzy qëndron në relativitetin e rëndësisë së një përgjigjeje ekzakte: Sa e rëndësishme është të marrësh një përgjigje ekzaktësisht të saktë, kur mund të nevojitet një përgjigje e përgjithshme? Edhe pse logjika fuzzy është metodë e re, koncepti i aplikimit të saj bazohet në arsyetimin e njeriut, që është një aftësi e hershme. Në Llogjikën Fuzzy vihet në balancë saktësia dhe kuptimi i përgjithshëm i një përgjigjeje. Logjika Fuzzy, ne kete studim paraqitet si një mënyrë alternative për vendim marrjen në planifikim, duke përfshirë aktorët me ndikim në proceset vendim-marrëse. .

Hipoteza e ketij kerkimi qendron nese logjika fuzzy mund të shfrytëzohen ne sferën e e vendim marrjeve ne planifikim ?

HOPKINS (2001) sugjeron se vendim marrja eshte nje angazhim per te vepruar (ose jo) dhe eshte krijuar nga individe ose institucione.

Rendesia e vendimit percaktohet nga ajo cfare do te sjelli ne kontekstin real. Eventualisht sa me i madh numri i pjesemarresve te perfshire me teper kompleks dhe i rendesishem do te behet procesi. Rendesia e tij gjithashtu varet nga fusha qe synon, tendencen per ndryshim ose ndikim. Nje pike kyce e ketij diskutimi mbetet qe vendim marrja me cdo lloj metodologjie duhet te justifikohet.

